

RAPORT I VLERESIMIT TE NDIKIMIT NE MJEDIS PER OBJEKTIN:

“RIKONSTRUKSIONI OBJEKTEVE TE ISH REPARTIT "RENEA" PËR
AKOMODIMI E DREJTORISË FORCËS SË POSAÇME OPERACIONALE”

(Projekt-Zbatim)



INVESTITOR	INXHINIER PROJEKTUES	PROJEKTUES
Drejtoria e Pergjithshme e Policise Se Shtetit	<i>Ekspert Mjedis Ing. Saidjon KODHELAI</i> <i>Ing. Agim HASALAMI</i> <i>Ing Gjeomjedis Bledar Hasalamaj</i>	“INSTITUTI DEKLIADA- ALB” shpk
		

PERMBAJTJA E STUDIMIT

PERMBAJTJA E STUDIMIT	2
HYRJE	5
1.QELLIMI DHE OBJEKTIVAT E VNM-SE.....	6
KUADRI LIGJOR	7
1 QELLIMI I PROJEKTIT	11
METODOLOGJIA	11
PERSHKRIMI I PROJEKTIT	12
2.1 PERSHKRIMI I STUDIMIT	12
2.2 PERSHKRIMI I SHKURTER I GJENDJES EKZISTUESE.....	12
3. PERSHKRIMI I KARAKTERISTIKAT FIZIKE TE SIPERFAQES KU ESHTË PROPOZUAR PROJEKTI	22
3.1 KLIMA.....	22
3.1.1 TEMPERATURA E AJRIT	22
3.1.2 RESHJET	23
3.1.3 DIELLEZIMI	23
3.1.4 ERA	24
3.3 GJEOMORFOLOGJIA DHE GJEOLGJIA E ZONES	26
3.4 SIZMICITETI.....	27
3.4.1 TEKTONIKA RAJONALE DHE SIZMICITETI.	27
3.4.2 SIZMICITETI NE ZONEN E STUDIMIT	27
3.6 EKOSISTEMET TOKESORE	28
4.PERSHKRIMI I MJEDISIT EKOLOGJIK, SOCIAL DHE CILESIA E MJEDISIT TE SIPERFAQES KU PROPOZOHET TE ZBATOHET PROJEKTI.....	29
4.1 PERSHKRIMI I BIODIVERSITETIT DHE CILESIA E MJEDISIT NE ZONEN E PROJEKTIT	29
4.1.1 FLORA	29
4.1.2 FAUNA.....	31
4.1.2.1 HERPETOFAUNA (AMFIBET DHE REPTILET).....	33
4.1.2.2 ORNITOFAUNA (SHPENDET).....	34
4.1.2.3 MAMMALOFAUNA (GJITARET).....	34
4.2.1 CILESIA E UJERAVE SIPERFAQESORE DHE NENTOKESORE	35
4.3 PERSHKRIMI I MJEDISIT SOCIAL TE ZONES.....	39
4.3.2 PUNESIMI DHE NIVELI I JETESES.....	41
☐ 5. INFORMACION PER PRANINE E BURIMEVE UJORE NE SIPERFAQEN E KERKUAR NGA PROJEKTI DHE NE AFERSI TE SAJ.....	43
6. NDIKIMET E MUNDSHME NEGATIVE NE MJEDIS TE PROJEKTIT, PERFSHIRE NDIKIMET NE BIODIVERSITET, UJE, TOKE DHE AJER;	44
VLERESIMET E NDIKIMEVE NE MJEDIS	44
6.1 NDIKIME NE ATMOSFERE.....	44
6.2 NDIKIMI NE TOKE DHE UJE	44
6.3 NDIKIMI NE REGJIMIN DHE PERDORIMIN E UJERAVE	45

REALIZIMI I PROJEKTIT PER OBJEKTIN E CAKTUAR NUK DO TE NDIKOJ NE UJERAT SIPERFAQESOR DHE NENTOKESOR TE ZONES. PROJEKTI NUK DO TE NDIKOJE NEGATIVISHT NE REGJIMIN DHE PERDORIMIN E UJIT.	45
6.4 NDIKIMI NE BALANCEN E EKOSISTEMIT.	45
6.5 NDIKIMI NE PERBERJEN E FLORES DHE FAUNES	45
6.6 NDIKIMI NE ZHURMA DHE VIBRIMET	45
6.7 NDIKIMI NE EROZION.....	46
6.8 NDIKIMI NE MJEDISIN HUMAN	46
6.12 Ndikimet e emtimeve kimike ne toke dhe rrethimet.....	47
6.10 Ndikimi ne habitate, objektet me status te cilesuar.....	47
6.11 NDIKIM NE PERDORIMIN E TOKES DHE BURIMEVE	47
6.12 NDIKIM NE KIME DHE AJER.....	47
6.13 NDIKIMI NE TURIZEM	47
6.14 NDIKIMI NE EKONOMI.....	48
6.15 NDIKIM NE SHENDETIN HUMAN	48
6.17 NDIKIME NE PEISAZH DHE NE TRASHEGIMIN KULTURORE ESTETIKE	48
6.18 NDIKIMET E PROJEKTEVE TE TJERA QE SHOQEROJNE PROJEKTIN	48
6.19 TABELA PERMBLEDHESE E NDIKIMEVE NEGATIVE DHE POSITIVE NE MJEDIS.....	48
7. PERSHKRIMI PER SHKARKIMET E MUNDSHME NE MJEDIS, TE TILLA SI: UJERA TE NDOTURA, GAZE DHE PLUHUR, ZHURMA, VIBRIME, SI DHE PER PRODHIMIN E MBETJEVE	51
7.1 TRAJTIMI I UJERAVE TE NDOTURA DHE LARGIMI I MBETJEVE.....	51
7.2 KLASIFIKIMI I MBETJEVE, MBETJET E RREZIKSHME	51
7.3 MBETJET E NGURTA	52
7.4 PLUHURI.....	52
7.5 TRAJTIMI I VAJRAVE TE PERDORUR	52
7.6 MBETJET INERTE	53
7.7 MENAXHIMI I MBETJEVE NGA GOMAT E PERDORURA.....	53
7.8 BATERITE, AKUMULATORET DHE MBETJET E TYRE	54
7.9 TRANSFERIMI I MBETJEVE JO TE RREZIKSHME	54
8. INFORMACION PER KOHEZGJATJEN E MUNDSHME TE NDIKIMEVE NEGATIVE TE IDENTIFIKUARA	54
9. TE DHENA PER SHTRIRJEN E MUNDSHME HAPESINORE TE NDIKIMIT NEGATIV NE MJEDIS, QE NENKUPTON DISTANCEN FIZIKE NGA VENDNDODHJA E PROJEKTIT, DHE VLERAT E NDIKUARA QE PERFSHIHEN NE TE	55
9.1 HAPESIRA KU DO TE NDERTOHEJ VEPRAT , NDIKIMET NEGATIVE.....	55
9.2 HAPESIRA JASHTJE SIPERFAQES KU DO TE NDERTOHEJ VEPRAT QE DO KETE NDIKIME NEGATIVE.....	55
9.3 NDIKIMI I PROJEKTIT GJATE FAZES SE NDERTIMIT	55
10. MUNDËSITË E REHABILITIMIT TE MJEDISIT TE NDIKUAR DHE MUNDËSITË E KTHIMIT TE MJEDISIT TE NDIKUAR TE SIPERFAQES NE GJENDJEN E MEPARSHME	55
10.1 PLANI I REHABILITIMIT TE MJEDISIT	57

11. MASAT REHABILITUESE NE RAST NDOTJE DHE DEMTIMI NE MJEDIS...	60
11.1 MASAT KONKRETE PER MBROJTJEN E CILESISE SE AJRIT	61
11.2 MASAT KONKRETE PER ADMINISTRIMIN E MBETJEVE TE NGURTA	62
11.3 MASAT KONKRETE PER MBROJTJEN NGA ZHURMAT	62
-SHKALLET ME NJE RRUGE EVAKUIMI	64
-PARASHIKIMI I ZONAVE TE SHPETIMIT	64
-SHKALLET, KONSTRUKSIONI I SHKALLEVE TE EVAKUIMIT.....	66
-SHENJAT E DALJES	66
Rrufepritesit	67
12. PLANI I MONITORIMIT TE MJEDISIT	67
☐ <i>Plani i menaxhimit të mbeturinave të prodhuara gjatë zbatimit të projektit</i>	<i>69</i>
13 . NDIKIMET ME NATYRE NDERKUFITARE.....	70
14. PERFUNDIME DHE REKOMANDIME	71

➤ **HYRJE**

Bazuar në kontratën lidhur ndërmjet Drejtorisë së Përgjithshme të Policisë së Shtetit dhe shoqërisë “Instituti Dekliada-Alb” sh.p.k me objekt “*Rikonstruksioni objekteve të ish Repartit "Renea" për Akomodimi e Drejtorisë Forcës së Posaçme Operacionale*”, është bërë vlerësimi i rendesisë dhe pajtueshmërisë së mjedisit. Ky dokument do të konsiderohet si pjesë përbërëse e Dokumentacionit të Studim Projektim dhe Preventivit Përfundimtar për objektin e mësipërm dhe si i tillë duhet të lexohet së bashku me raportet perkatese, vizatimet teknike dhe detajet e projektit.

Vendi ynë është anëtare e një numri konventash ndërkombëtare, si rrjedhojë është i detyruar të zbatojë një sistem sa më efektiv në fushat ekonomik-social-mjedisore, për rregullimin e territorit sidomos në funksion të zgjidhjes së problemeve të ndryshme mjedisore. Mjedi është burimi i gjithçkaje për të cilën njerëzit kanë nevojë për të jetuar dhe për tu zhvilluar. Sa më i degraduar të jetë mjedi aq më keq ndikon në shëndetin e njeriut dhe zhvillimin ekonomik-social. Prandaj duhet një menaxhim sa më i mirë i mjedisit natyror në lidhje me aktivitetin njerëzor që po zhvillohet çdo ditë e më shumë. Në Shqipëri, zhvillimi i veprimtarisë ekonomike dhe tranzicioni i vështirë drejt ekonomisë së tregut ka ushtruar trysni të fortë në mjedis duke ndikuar negativisht në të. Investimet e reja kanë sjellë ndikime në mjedis, por tashmë është arritur që shumë prej veprimtarive që ushtrojnë aktivitet brenda territorit të Republikës së Shqipërisë, ti nënshtrohen vlerësimit të ndikimit në mjedis përpara miratimit dhe zbatimit të tyre si qëllim për të parandaluar krijimin e zonave të tjera të ndotura, ky qëllim është kaq i rëndësishëm sa që theksojmë që parandalimi është edhe më i mirë edhe më pak i kushtueshëm sesa kurimi, (parimi i parandalimit).

Objekti që do të vlerësohet në këtë Raport të Vlerësimit të Ndikimit në Mjedis për Per Ish Repartin “Renea” Për Akomodimin e Drejtorisë Forcës Së Posaçame Operacionale, merr në konsideratë:

- të minimizojë ndikimet e drejtpërdrejta në mjedis dhe në radhë të parë në elementet prioritarë
- si rruajtja e tokës, kontrolli i zhurmave dhe ruajtja e cilësisë së ujit dhe ajrit, si dhe
- të ruajë ose rehabilitojë mjedisin natyror përmes elementeve të reja të ndërhyrjes pozitive,

punimeve të veçanta në kuadër të projektit ose paralel me të, të cilët sigurojnë vijueshmërinë e qëndrueshme

➤ Raporti i vlerësimit të ndikimit në mjedis është arritur duke:

- Paraqitur gjendjen reale të ndikimit të këtij aktiviteti në mjedisin human.
- Analizuar të gjithë faktorët pozitivë dhe negativë mjedisore.
- Duke dhënë rekomandime për masat zbutëse dhe minimizimin e ndikimeve

negativë në mjedis.

- Per te arritur kete eshte:
- Shfrytezuar informacioni baze i zones
 - Shfrytezuar dokumentacionin teknik dhe juridik
 - Organizim i vizitave ne terren me ekspertet e fushes

1.1 Qellimi dhe objektivat e VNM-se

Mjedisi eshte bazamenti, mbi te cilin realizohet procesi i zhvillimit ekonomik dhe social ne nje territor te caktuar. Mbrojtja e tij dhe menaxhimi i qendrueshem i burimeve dhe pasurive natyrore, qe gjenden ne kete mjedis, perben nje element kyç ne krijimin e nje standarti te mire jetese per popullsine aktuale dhe nje garanci per brezat e ardhshem.

Qellimi themelor i projektit eshte Rikonstruksioni objekteve të ish Repartit "Renea" për Akomodimi e Drejtorisë Forcës së Posaçme Operacionale dhe synimi kryesor i pergatitjes se Raportit te Vleresimit te Ndikimit ne Mjedis eshte qe te identifikohen nderthurjet e mundshme te projektit me mjedisin fizik e social dhe me politikat e mbrojtjes se mjedisit per zonat ku do te zhvillohet projekti.

Ky raport eshte hartuar ne perputhje me kerkesat e Legjislacionit Shqiptar dhe Direktivat e Bashkimit European per Vleresimin e Ndikimit ne Mjedis, me akte juridike ligjore dhe nenligjore specifike qe rregullojne ushtimin e aktivitetit te investimeve dhe gjithashtu aktet ligjore lidhur me mbrojtjen e mjedisit.

Vleresimi i Ndikimit ne Mjedis eshte nje proces sistematik qe synon te siguroje se jane identifikuar dhe jane marre ne konsiderate te gjitha pasojat mjedisore dhe social-ekonomike te zhvillimit te propozimeve per aktivitetin, si gjate fazes se pergatitjes se tij dhe pas zbatimit. Synimi kryesor i pergatitjes se Raportit te Vleresimit te Ndikimit ne Mjedis eshte te identifikohen nderthurjet e mundshme te projektit me mjedisin fizik e social dhe me politikat e mbrojtjes se mjedisit per zonen ku do te zhvillohet projekti.

Me konkretisht, ky dokument ka per qellim:

- ✓ Te evidentoje pikeprerjet dhe bashkerendimin e aktivitetit me kuadrin rregullator legjislativ kombetar dhe nderkombetar ne fushen e mjedisit;
- ✓ Te pershkruaje vlerat natyrore dhe mjedisore ne zonen ku do te zhvillohet aktiviteti dhe te identifikojte statusin mbrojtjes se saj;

- ✓ Te identifikojë ndikimet e mundshme thelbësore negative në vlerat natyrore dhe në mjedis duke propozuar njëkohësisht masat për zbutjen e tyre dhe mbrojtjen e mjedisit nga këto ndikime;
- ✓ Te lehtësojë vendim-marrjen e organeve kompetente planifikuese dhe mjedisore për projektin;
- ✓ Te kontribuojë në përmirësimin e menaxhimit të ndikimeve në mjedis duke përfshirë publikun dhe aktoret e tjera vendimmarres;
- ✓ Te identifikojë kufizimet, mundësitë dhe resurset të cilat do të influencojnë mbi mënyrën se si duhet të hartohen propozimet për zhvillimin e këtij projekti;
- ✓ Te fokusojë problemet mjedisore si kyçe për planifikimin e zhvillimit të projektit duke promovuar kuptimin me të mirë të marrëdhënieve ndërmjet masave për mbrojtjen dhe infrastrukturën specifike si dhe mjedisit dhe komunitetit përreth;
- ✓ Te harmonizojë ndikimet dhe përfitimet, pra efektet e kombinuara të propozimeve të ndryshme për zhvillimin e veprimtarisë së propozuar me veprimtaritë ekzistuese.

Vlerësimi i ndikimit në mjedis është një vlerësim i ndikimeve të mundshme pozitive dhe negative që një projekt apo aktivitet mund të ketë mbi mjedisin; përfshirë aspektet natyrore, sociale dhe ekonomike.

Ky raport paraqet një përshkrim të projektit, gjendjen ekzistuese të mjedisit dhe jep një vlerësim të ndikimit në mjedis nga ndërtimi i objektit. Synimi i këtij vlerësimi është të sigurojë që vendimmarresit të marrin në konsideratë ndikimet në mjedis përpara se të miratojnë projektin. Vlerësimi i Ndikimit në Mjedis në Shqipëri bazohet në ligjin Nr. 10440, datë 07.07.2011 “Për Vlerësimin e Ndikimit në Mjedis”, i ndryshuar.

Bazuar në dispozitat e Ligjit nr.10440 datë: 07.07.2011 “Për vlerësimin e ndikimit në mjedis”, veprimtaria e propozuar duhet t’i nënshtrohet procedurës së Vlerësimit Paraprak të Ndikimit në Mjedis, sipas shtojcës II, Projektet Që i nënshtrohen Procedurës Paraprake Të Vlerësimit Të Ndikimit Në Mjedis, (10) Prodhime infrastrukture

1.2 Kuadri ligjor

Legjislacioni mjedisor është hartuar në kuadër të mbrojtjes së mjedisit në një nivel të lartë, ruajtjen dhe përmirësimin e tij, parandalimin dhe pakesimin e rreziqeve ndaj komponenteve të veçanta të mjedisit duke siguruar kushte për një zhvillim të qëndrueshëm.

Nder ligjet me kryesore ne lidhje me projektin, do te permendim:

- Ligji nr.10448, date 14.07.2011 “Per lejet e mjedisit”, i ndryshuar
- Ligji nr. 81/2017 “ Per Zonat e mbrojtura”
- Ligj, Nr.107/2014, " Per Planifikimin dhe Zhvillimin e Territorit", i ndryshuar
- Ligji nr.60/2014, date 19.06.2014 “Per disa ndryshime ne ligjin nr.10448, date 14.07.2011 “Per lejet mjedisore”, te ndryshuar
- Ligji nr.44/2013, date 14.02.2013 “Per disa ndryshime ne ligjin nr.10448, date 14.07.2011 “Per lejet e mjedisit”,
- Ligji nr.10431, date 09.06.2011 “Per mbrojtjen e mjedisit”, i ndryshuar.
- Ligji nr.31/2013, date 14.02.2013 “Per disa ndryshime ne ligjin nr.10431, date 09.06.2011 “Per mbrojtjen e mjedisit” .
- Ligji nr.10440, date 07.07.2011 “Per vleresimin e ndikimit ne mjedis”,i ndryshuar.
- Ligji nr.10463, date 22.09.2011 “Per manaxhimin e integruar te mbetjeve” , i ndryshuar.
- Ligji nr.156/2013, date 10.10.2013 “Per disa ndryshime ne ligjin nr.10463, date 22.09.2011 “Per manaxhimin e integruar te mbetjeve”,te ndryshuar.
- Ligji nr.32/2013, date 14.02.2013 “Per disa ndryshime ne ligjin nr.10463, date 22.09.2011 “Per manaxhimin e integruar te mbetjeve”.
- Ligji nr.10006, date 23.10.2008 ”Per mbrojtjen e faunes se eger”, i ndryshuar
- Ligji nr. 41/2013, date 14.02.2013 “Per disa shtesa dhe ndryshime ne ligjin nr.10006, date 23.10.2008 ”Per mbrojtjen e faunes se eger” , te ndryshuar.
- Ligji nr.9587, date 20.07.2006 “Per mbrojtjen e biodiversitetit”, i ndryshuar
- Ligji nr.68/2014, date 03.07.2014 “Per disa shtesa dhe ndryshime ne ligjin nr.9587, date 20.7.2006 “Per mbrojtjen e biodiversitetit”, te ndryshuar
- Ligji Nr.9048, datë 07.04.2003 “Për Trashëgiminë Kulturore”, i ndryshuar.
- Ligji Nr. 162/2014 “Për Mbrojtjen e Cilësisë së Ajrit në Mjedisit”.
- Ligji nr.37/2013, date 14.02.2013 “Per disa shtesa dhe ndryshime ne ligjin nr.9587, date 20.7.2006 “Per mbrojtjen e biodiversitetit”,
- Ligji nr. 48/2016 për disa ndryshime dhe shtesa në ligjin nr. 9385, datë 4.5.2005, “për pyjet dhe shërbimin pyjor”, të ndryshuar

➤ **Vendime te Keshilit te Ministrave**

- Vendim i KM nr. 912, date 11.11.2015 "Per miratimin e metodologjise kombetare te procesit te vleresimit te ndikimit ne mjedis"
- Vendim Nr. 686, datë 29.07.2015 “Për miratimin e rregullave, të përgjegjësive e të afateve për zhvillimin e procedurës së vlerësimit të ndikimit në mjedis (VNM) dhe procedurës së transferimit të vendimit e deklaratës mjedisore”, i ndryshuar

- Vendim i KM nr. 575, datë 24.6.2015 "Për miratimin e kërkesave për menaxhimin e mbetjeve inerte"
- Vendim i KM nr.99, datë 18.2.2005 "Për Miratimin E Katalogut Shqiptar Të Klasifikimit Të Mbetjeve"
- Vendim i KM nr. 652, datë 14.9.2016, "Për rregullat dhe kriteret për menaxhimin e mbetjeve nga gomat e përdorura"
- Vendim i KM nr. 371, datë 11.6.2014, "Për miratimin e rregullave për dorëzimin e mbetjeve të rrezikshme dhe të dokumentit të dorëzimit të tyre".
- Vendim i KM Nr. 765, datë 7.11.2012 për miratimin e rregullave për grumbullimin e diferencuar dhe trajtimin e vajrave të përdorura.
- Vendim i KM, Nr.866, Dt. 04.12.2012 Për bateritë, akumulatorët dhe mbetjet e tyre
- Vendim i KM, Nr.229, Dt :23.04.2014 Për miratimin e rregullave për transferimin e mbetjeve jo të rrezikshme dhe informacionit që duhet të përfshihet në dokumentin e transferimit
- Vendim Nr.994, datë 2.7.2008 për tërheqjen e mendimit të publikut në vendimmarrje për mjedisin

Synimet e hartimit te VNM-së

Vlerësimin e përgjithshëm, të integruar dhe në kohë të ndikimeve mjedisore, të projektit që do zbatohet, duke parandaluar dhe zbutur ndikimet negative në mjedis; Një proces vlerësimi të hapur dhe të administruar me paanshmëri, nëpërmjet pjesëmarrjes së organeve qendrore e vendore, të publikut, të organizatave jofitimprurëse për mjedisin, të propozuesit të projektit dhe të personave fizik dhe juridik, të specializuar në këtë fushë.

Hartimi i këtij raporti VNM -je është bazuar gjithashtu në ligjin për mbrojtjen e mjedisit, i cili në vetvete synon:

- Të rregullohet marrëdhënia ndërmjet njeriut dhe mjedisit,
- Të mbrojë përbërësit e mjedisit dhe proceset mjedisore
- Te sigurojë kushtet materiale për zhvillimin e qëndrueshëm, duke plotësuar kuadrin e nevojshëm për zbatimin e kërkesës kushtetuese për një mjedis ekologjikisht të pastër.
- Përdorimin racional të mjedisit dhe kufizimin e shkarkimeve e te ndotjeve ne te, parandalimin e dëmtimit të tij, rehabilitimin dhe shëndoshjen e mjedisit të dëmtuar;
- Përmirësimin e kushteve mjedisore, qe lidhen me cilësinë e jetës dhe mbrojtjen e shëndetit të njeriut;
- Ruajtjen dhe mirëmbajtjen e burimeve natyrore, te përsëritshme dhe te papërsëritshme, administrimin racional dhe te frytshëm te tyre;
- Bashkërendimin e veprimtarive shtetërore për te përmbushur kërkesat për mbrojtjen e mjedisit;
- Bashkëveprimin ndërkombëtar ne fushën e mjedisit;
- Nxitjen dhe pjesëmarrjen e publikut ne veprimtaritë për mbrojtjen e mjedisit;

- Bashkërendimin e zhvillimit ekonomik dhe shoqëror të vendit me kërkesat e zhvillimit të qëndrueshëm;
 - Ngritjen dhe forcimin e rrjetit institucional të mbrojtjes së mjedisit në nivel qendror dhe vendor.

Elementet kryesore strategjike të mbrojtjes së mjedisit

Elementet kryesore strategjike të mbrojtjes së mjedisit që janë gjithashtu detyruesisht të zbatueshme edhe për subjektin ndertues që zhvillon aktivitetin e saj, të përshkruar në këtë raport VNM -je janë:

- a) parandalimi dhe ulja e ndotjes së ujit, ajrit, tokës dhe ndotjeve të tjera të çdo lloji;
- b) ruajtja e shumëllojshmërisë biologjike sipas bazës natyrore, biogeografike të vendit;
- c) përdorimi racional i burimeve natyrore dhe minerare dhe shmangia e mbishfrytëzimit të tyre;
- ç) riaftësimi ekologjik i zonave të dëmtuara dhe të ndotura nga veprimtaria e njeriut dhe dukuritë natyrore shkatërruese;
- d) ruajtja e ekuilibrit ekologjik dhe përmirësimi i cilësisë së jetës

Gjate vënies në punë të veprimtarive dhe instalimeve, personat fizikë e juridikë sigurojnë:

- a) zbatimin e të gjitha masave që parandalojnë shkarkimet mbi norme dhe ndotjen e mjedisit;
- b) shmangien dhe pakësimin e mbetjeve dhe, aty ku përdorimi i tyre nuk është i mundur teknikisht ose ekonomikisht, neutralizimin e tyre, duke shmangur dhe pakësuar ndikimin në mjedis;
- c) parandalimin e aksidenteve industriale dhe kufizimin e pasojave të tyre;
- ç) kthimin e vendit në kushte të kënaqshme mjedisore pas përfundimit të veprimtarisë;
- d) njoftimin për çdo ndryshim të planifikuar të linjës teknologjike;
- dh) respektimin e kërkesave dhe të kushteve të lejes mjedisore;
- e) njoftimin e agjencive rajonale të mjedisit, jo më rrallë se një herë në 3 muaj, për rezultatet e vetëmonitorimit dhe, në çdo kohë, për aksidentet ose emergjencat me ndikim negativ në mjedis;
- ë) plotësimin e kërkesave të Inspektoratit të Mjedisit gjatë kryerjes së kontrollit të veprimtarisë së tyre;
- f) njohjen e publikut me gjendjen e mjedisit dhe profilin mjedisor të veprimtarisë së tyre;
- g) mbajtjen e regjistrave për shkarkimet në mjedis, për përdorimin e ujit dhe të energjisë, si dhe për teknikat e përdorura.

1.3 Qellimi i projektit

Qellimi themelor i projektit është **Rikonstruksioni objekteve të ish Repartit "Renea" për Akomodimi e Drejtorisë Forcës së Posaçme Operacionale** dhe qëllimi kryesor i VNM është të përcaktojë dhe vlerësojë ndikimet që do të ketë në mjedis zhvillimi i projektit gjatë ndërtimit dhe shfrytëzimit.

Për realizimin e projektit, projektuesi duhet të njihet me informacionin ekzistues lidhur me të dhënat që kërkon projekti sipas detyrës së projektimit dhe për çdo problem duhet të konsultohet me autoritetin kontraktor. Cilesia e studimit dhe projektimit duhet të jetë e tillë, që të arrihen standartet e kërkuara dhe të plotësojë kushtet teknike të projektimit në fuqi.

➤ Metodologjia

Për hartimin e raportit të VNM, porositesi vuri në dispozicion të hartuesve të raportit materialin teknik dhe juridik dhe u realizuan vizita në terren. Ky raport vlerësimi përgatitet me kërkesë të investitorit. U kryen inspektime në terren për të konstatuar vendodhjen, karakteristikat territoriale të kësaj zone, gjendja e faktoreve të mjedisit, si dhe për të tërhequr mendimin e komunitetit të zonës dhe zhvillimin e aktivitetit.

2. PERSHKRIMI I PROJEKTIT

2.1 Pershkrimi i studimit

Qëllimi i Projektit: Rikonstruksioni objekteve të ish Repartit "Renea" për Akomodimin e Drejtorisë së Forcës së Posaçme Operacionale në përputhje me nevojat për ambientet laboratorike dhe administrative sipas standardeve bashkëkohore europiane. Objektivi i përgjithshëm është rikonstruksioni i godinave duke plotësuar kushtet dhe nevojat e paraqitura në projekt detyrë.

Për të arritur objektivin e përgjithshëm të projektit në vijim janë dhënë pritshmerite kryesore që do të arrihen nga Konsulenti:

- Studim – Projektim i objektit të propozuar si dhe procesi i zhvillimit të projektit Arkitektonik e Inxhinierik
- Perllogaritja e Kostove
- Raporte teknike

2.2 Pershkrim i shkurtër i gjendjes ekzistuese

Të dhëna të përgjithshme

Zbatimi i këtij projekti do të kryhet në këto zone pasi është konsideruar si pronë e përshtatshme, territori i ish-Repartit "Renea" e cila është pronë e M.B.së dhe në përdorim të Drejtorisë së Përgjithshme të Policisë së Shtetit, sipas VKM nr.250 datë 24.04.2003 "Për miratimin e listës së inventarit të pronave të paluajtshme shtetërore, të cilat i kalojnë në përgjegjësi administrimi, Ministrisë së Rendit Publik", të ndryshuar.

Aktualisht kjo pronë është e lirë, pas zhvendosjes së repartit "Renea" në një territor tjetër, e për pasojë këto objekte janë gjykuar të përshtatshme për akomodimin dhe funksionimin e Drejtorisë së Forcës së Posaçme Operacionale. Kjo, nisur nga fakti se :

Vendndodhja e territorit të identifikuar, plotëson kushtet për aktivitetin administrativ për një strukturë, siç është Forca e Posaçme Operacionale. Sipërfaqja e pronës, plotëson më së miri kërkesat jo vetëm për akomodimin (zyra pune) e strukturës qendrore por plotëson kushtet edhe për aktivitete të tjera specifike që ka kjo strukturë, për vetë faktin se ka disa objekte (Ikt, 2kt, 2kt+p) , sheshe parkimi, sheshe stërvitje, garazhe makinash, poligon qitje..etj. Prona zotëron statusin e Pronës-Shtet (ish Reparti "Renea") . Zona ndodhet në periferi të Tiranës në fund të rrugës "Muhamed Deliu". Terreni është kodrinor me izoipse të ndryshme. Për në këto shesh studimi ka akses vetëm nga rruga kryesore për ruajtjen e privatesisë së " Ish Reneas ".



Figura. Vendi ku do te nderhyhet.

Sheshi i nderhyrjes perbehet nga dy godina kryesore 2 kateshe si dhe me objekte te tjera 1 kat qe sherbejne si magazine parkimet etj. Ne shesh kemi nje rruge qe kalon mes per mes tij qe ben lidhjen e godinave me njera tjetren, e cila eshte ne gjendje te pashtuar dhe pa ndricimin e nevojshem . Gjithashtu kemi pranine e nje perroi me thellesi te ndryshme mbi 3 metra pergjate gjatesise se tij. Gjelberimi paraqitet problematik me se shumti per shkak te pranise se shkurreve te cilat e bejne te pamundur aksesin ne disa pjese te ketij sheshi ku do te nderhyjme.





Figura 1 Siperfaqet e nderhyrjes

Reparti “Ish Renea” eshte me dalje ne rrugen kryesore “Muhamed Deliu”.Reparti ndodhet 20min larg me automjet nga qendra e Tiranës. Rruga qe lidh qendren me kete zone eshte 6 km pergjate “Xhenfize Kekos” dhe “Hoxha Tahsim”

Ortofoto Sheshi "Ish Reparti Renea"



Kjo zone se bashku me disa zona te tjera ne qytet jane nje nga fragmentet e dallueshme ne relievin e qytetit te cilat jane ne marredhenie te ndryshme me kontekstin urban. Kjo zone eshte e pozicionuar ne mes nje zone suburbane me ndertime te larta me funksion banim dhe sherbimi. Zona nuk ka stil arkitektonik te dallueshem por ndertime informale. Kjo zone e pervijuar me kontur te qarte ndodhet ne nje zone kaotike por edhe ne afersi me malin e Dajtit. Zona ndodhet ne nje terren ngrites me pamje ku objektet bllokojne ne perspektiv horizontin.



Figura. Pamje te Ish fjetores per rikonstruksion



Figura. Pamje te ish Komandes



Figura. Pamje te parkimeve te mbyllura .

Hyrja kryesore, gjëndet në pjesën lindore të pronës me dalje në Rrugen „Muhamed Deliu”, duke krijuar mundësi aksesit të mjaftueshëm për qarkullimin dhe lëvizjen e lirë të mjeteve dhe te njerezve. Imazhet si më poshtë:

Sipërfaqja totale e truallit është : 333571, 6 m²

Sipërfaqja e ndertimi eshte : 3701.3 m²

Zona ka pozicionim gjatesor veriperendim-juglindje. Ne drejtimin veri-perendimor terreni peson thyerje nga pika e hyrjes deri ne piken fundore. Izoipset kane orientimin veriperindim-juglindje ne nje drejtim dhe ngrihen paralelisht njeri me tjetrin. Organizimi i terrenit eshte I pasistemuar dhe I lene ne keto disnivele te cilat sjellin dhe zona qe kan mbetur te vdekura pa akses. Gjithashtu terreni varet dhe nga prania e perroit I cili eshte I hapur me nje disnivel prej 3-5 metrash te cilat sjellin problematika te ndryshme per shkak te mungeses se ndricimit dhe gjelberimit ne menyre rastesor duke shkeputur dy pjese te sheshit me njera tjetren te cilat lidhen vetem me ane te nje ruge te pasistemuar. Ne projekt do te behet rehabilitimi i ketij perroi si nje kanal hidraulik I mbyllur duke

zgjeruar me shume hapësirë si dhe për të krijuar hapësirat e nevojshme për parkim gjelbër si dhe sheshe stërvitjeje për DFPO-ne.





Figura. Relievi i sipërfaqes ndërtimit

Aksesi për në këto zone do të bëhet nga hyrja kryesore nga rruga “Muhamed Deliu” dhe do të nisë me një shesh përballë fjetores dhe me pas në vazhdimin e saj do të kemi një rrugë dytësore në kalimshme e cila do të na çojë deri tek kalceto me një thyerje që do të na çojë tek poligoni. Kjo rrugë krijon hapësira të ndryshme gjelbërimi si dhe sheshe parkimi qëndrimi shpërndarje etj. Është një rrugë në kalimshme që vjen në ngjiturje me një gjëresë prej 4 metrash. Në disa pjesë të tij ku është e nevojshme do të ndërtohen trotuare për sigurinë e personave që do të punojnë në DFPO pasi terreni është me reliev dhe janë të detyruar të kalojnë përgjatë kësaj rruge. Do të bëhet shtrimi i kësaj rruge me të gjithë parametrat e kërkuar europiane si dhe me shtresat përkatëse.

Parkimi i makinave eshte mbitokesor ne 3 zona te dedikuar per Ish Repartin. Hapesirat jane te bollshme per parkim dhe cdo godine ka hapesira sheshe per parkim ne menyre qe distance e arritjes te jet sa me e shkurter. Do te behet nje riorganizim I parkimeve te reja per nje nr te caktuar automjesh. Do te kemi parkime te hapura dhe te mbyllura qe do te sherbejne per akomodimin e automjeteve te posacme qe duhet te kene sigurine e tyre. Parkimet e jashtme me mbylljen e perroit do te organizohet ne kete ha Objektet e Ish Repartit Renea pergjithesisht jane organizuar pergjate perimetrit te nje aksi te gjere gjatesor te gjelberuar qe shkon deri ne fund te zones me nje kend 90 grade, qe perben edhe aksin organizativ qe konturohet nga godinat.

Ky aks nderpritet ne disa sheshe te dedikuar per grumbullimin, rrjeshtimin dhe shperndarjen e punonjesve. Te gjitha godinat kane arritshmeri me makine ne kete aks gjatesor. Ky aks gjatesor i gjelberuar eshte edhe aks levizjeje i dedikuar dhe per kembesoret per arritshmerine e godinave si dhe nje aks i gjelberuar, rekreativ. Gjeja qe vihet re eshte prania e siperfaqeve te shumta te gjelbra qe perben nje vlere per zonen. Zona jashte ketij aksi gjatesor qe shkon permes zones paraqitet e paorganizuar me hapsira te pasistemuara dhe pozicionim te godinave te ndertuar jo ne te njejten rend me pjesen pjesen tjeter .



Objektet kane lartesi te ndryshme katesh 1,2 kateshe, lartesia e te cilave nuk perceptohet nga hyrja per shkak te terrenit ngrites si dhe me pranine e gjelberimit te larte.

U vezhgua me vemendje hapsira per percaktimin e zonave me potencial per te pozicionuar godinat e reja te kerkuara, duke u bazuar ne organizimin funksional te gjith zones, ne siperfaqet si dhe ne impaktin viziv qe do kene keto objekte ne rritjen e impaktit te zones.

Tipologjite e nderhyrjes :

- Godina qe do shemben
- Godina qe do rikonstruktohen ne fasada me nderhyrje ne ritrajtim estetik, ne permiresimin e termoizolimit dhe ne zgjidhjen e hidroizolimit qe eshte problem evident per te gjith zone per shkak te karakteristikave ujembajtese te zones si dhe ne funksionalitetin e brendshem.
- Godina qe do rikonstruktohen dhe do riorganizohen ne hapsirat e brendshem dhe me nderhyrje ne fasada.




Figura Paraqitja e godinave ekzistuese

Gjendja vizive dhe funksionale ne te cilen paraqitet kompleksi nuk eshte ne lartesine e nje institucioni te kesaj kategorie per shkak te problematikave te shumta. Organizimi i godinave ne *Ish Repartin Renea* ndjek nje vendosje paralele te objekteve ne disa platforma dhe te shkallezuar njera me tjetren me nje shesh ne hyrje para godines kryesore. Territori eshte i sistemuar ne platforma me shkalle te amortizuara nga koha si dhe me gjelberim te perqendruar vetem ne hyrje te zones qe ze nje siperfaqe te konsiderueshme gati gjysmen e siperfaqes totale. Objektet jane 2 kateshe te ndertuara ne te njejten periudhe rreth viteve 90-te dhe paraqiten te pamortizuara ne pjesen me te madhe dhe te pershtatshme per tu riperdorur ne kerkesat e reja per zhvillimin e kesaj zone, per kete arsye eshte vleresuar qe keto godina do i nenshtrohen procesit te rikonstruksionit si dhe organizimit te brendshem. Ndersa ndertesat 1 kateshe paraqiten teper te amortizuara dhe ne

gjendje te papershtatshme per tu riperdorur per funksione te reja prandaj do ti nenshtrohen shembjes.




Figura Paraqitja e godinave qe shemben




Figura Paraqitja e godinave te cilat do ti nenshtrohen rikonstruksionit
Ish fjetorja eshte godine e ndertuar pas viteve 90-te dhe kerkon nderhyrje rikonstruksioni, vetem ne unifikimin e ngjyrave te fasadave duke i lidhur me pjesen tjeter te kompleksit si dhe organizimin e hapësirave te brendshme per pershtatjen per zyra.

3. PERSHKRIM I KARAKTERISTIKAT FIZIKE TE SIPERFAQES KU ESHTË PROPOZUAR PROJEKTI

3.1 Klima

3.1.1 Temperatura e ajrit

Ne rajonin e Tiranes, temperatura e ujit eshte me e larte ne muajet e veres (Korrik - Gusht), ku edhe sasia e energjise diellore eshte me e madhe, ndersa temperatura me e ulet eshte ne dimer, ne muajin Shkurt. Persa i perket vecorive sezonale mund te pohojme qe gjysma e ngrohje e vitit prill-shtator karakterizohet nga temperature mesatare 20.6°C ndersa gjysma e ftohte 12.4°C . Ecuria vjetore e temperaturave maksimale absolute te ajrit eshte e njejte me ate te temperaturave mesatare, pra me nje minimum ne janar dhe maksimum ne korrik ose gusht. Temperaturat maksimale absolute $>30^{\circ}\text{C}$ fillojne te regjistrohen qe nga muaji maj dhe vazhdojne deri ne shtator.

Temperatura maksimale absolute me e larte e vrojtuar eshte 38.6°C ne Korrik (viti 1988). Nje nga treguesit me te rendesishem per te karakterizuar temperaturat maksimale te ajrit eshte dhe mesatarja maksimale, vlerat e se ciles variojne nga 12°C ne janar deri ne 27.8°C ne korrik. Ne kete zone vrojtohen vlera jo shume te ulta te temperatures minimale absolute. Shfaqia e vlerave negative te ketij treguesi nuk eshte ngjarje e rralle.

Keto vlera sigurisht qe jane te pranishme ne gjysmen e ftohte te vitit. Minimumi absolut i tyre arrihet ne muajin janar (-6.0°C). Por duhet permendur gjithashtu duke vlera te ulta te ketij treguesi jane vrojtuar qysh ne nentor (-1.6°C) deri ne muajin mars (-5.2°C). Kjo zone, ashtu si edhe ne rastin e rrezatimit diellor, karakterizohet nga nje numer i madh i oreve me diell. Mesatarisht gjate vitit ka 2655 ore me diell, me vleren me te larte ne korrik me 355 ore dhe ate me te ulet ne dhjetor me 107 ore.

Tabela 1: Temperatura pergjate vitit ne Durres dhe ne Tirane

Mujore Temperatura		01	02	03	04	05	06	07	08	09	10	11	12
Mesatare °C		7.9	8.8	11.0	14.4	18.1	21.9	24.0	23.9	21.4	17.6	13.7	10.0
Mesatarja mujore	Mesatarja mujore	-11.6	11.7	14.2	16.6	20.7	23.8	26.2	25.8	24.0	20.2	15.8	12.1
	Mesatarja mujore	4.1	5.4	7.8	1.9	16.7	19.4	22.7	21.0	19.6	15.2	11.9	6.4
Max.absolute		18.8	22.1	24.9	28.6	31.3	35.0	37.7	39.0	34.0	32.2	26.0	21.7

Min.absolute	-7.4	-4.6	-3.0	2.4	6.2	11.0	13.6	11.0	8.2	5.0	2.0	-7.2
--------------	------	------	------	-----	-----	------	------	------	-----	-----	-----	------

3.1.2 Reshjet

Per shkak te veprimtarise se gjere ciklonare sasia me e madhe e reshjeve vihen re ne gjysmen e ftohte te vitit, dhe ajo me e ulet ne periudhen e ngrohte te tij. Zona ne studim eshte nje nga zonat qe karakterizohet nga sasi reshjesh vjetore te ulta mesatarisht 931mm ne vit te cilat bien kryesisht ne forme shiu. Muaji me me shume reshje eshte muaji nentor (132.9 mm), i ndjekur nga muaji dhjetor (113 mm). Muaji me me pak reshje eshte muaji korrik me 23.9 mm. Numri i diteve me reshje ≥ 1.0 mm varion nga 2.4 dite (korrik) deri ne 11.1 dite (dhjetor). Gjate vitit ka mesatarisht 86.4 dite me reshje ≥ 1.0 mm.

Zona ne studim nuk klasifikohet si zone me sasi te medha reshjesh 24-oreshe, ose me mire ajo ben pjese ne zonat ku shirat jane me pak te rrembyeshem. Megjithate nuk perjashtohen edhe rastet kur sasia maksimale 24-oreshe ka arritur 180.8mm dhe 182.5mm perkatesisht ne muajt nentor dhe tetor. Ndersa maksimumi 24 h per periudhen 30 vjeçare varion nga 43.0 mm ne korrik (per vleren me te ulet) deri ne 182.5 mm ne tetor te vitit 1962. Rreshjet jane nje element i rendesishem meteorologjik, qe ne rajonin e Tiranës kryesisht perfaqesohen nga shiu. Ne tabelen me poshte paraqitet sasia e rreshjeve sipas muajve dhe numuri i diteve me rreshje gjate vitit bazuar ne te dhenat shume vjeçare meteorologjike.

Tabela 2: Sasia e reshjeve mujore dhe numri i diteve me reshje gjate vitit bazuar ne te dhenat shume vjeçare meteorologjike

Muajt		01	02	03	04	05	06	07	08	09	10	11	12	Vjetor
Reshjet														
Reshjet mujore mm		112	98	86	60	57	28	12	20	35	131	164	150	983
Max 24 oresh mm		89	83.6	63	66.1	67	77	35	65.3	72.3	182.5	180.8	59	1042.6
Numri i diteve me reshje	0.1mm	13.3	11.5	10.7	8.8	7.5	4.9	3.5	3.5	5.7	10.7	12.4	14.4	106.9
	5 mm	6.1	5.5	5.1	3.5	3.3	1.8	1.0	1.5	2.5	5.4	8.5	7.2	51.4
	10mm	4.2	3.3	2.7	1.9	1.9	0.9	0.5	0.9	1.6	3.6	5.5	4.1	31.1

3.1.3 Diellezimi

Rajoni merr sasi te medha oresh diell. Vlera e zgjatjes vjetore te djellezimit leviz ne kufijte 2600-2700 ore.Edhe numeri i diteve me diell leviz nga 320-330 dite. Vlerat me te larta jane vrojtuar ne korrik, 373 ore me diell, dhe me te ultat ne dhjetor 118 ore. Edhe radiacioni diellor ndjek pothuaj

te njejten shperndarje vjetore si dhe djellezimi. Energjia diellore mesatare gjate nje viti eshte 1600 kW ore/m², vleat me te larta jane vrojtuar ne korrik 223.5 kW ore/m² dhe me te ultat ne dhjetor 52.9 kW ore/m², ne tabelen e meposhtme jane dhene mesataret shumevjecare mujore te shperndarjes se djellezimit si dhe radiacioni diellor i pergjithshem.

Tabela 3: Diellezimi (Ore) Dhe Radiacioni Diellor (Kw HM2)

Stacioni i monitorimit	1	2	3	4	5	6	7	8	9	10	11	12	Vjetore
Tirana	6.5	5.8	5.2	4.6	5.5	8.1	17.3	17.6	13.5	9.6	6.1	6.1	105.9

Tabela 4 : Vlera mesatare e diteve me re

Stacioni i monitorimit	1	2	3	4	5	6	7	8	9	10	11	12	Vjetore
Tirana	12.3	12.6	12.2	11.7	7.2	4.3	1.2	1.8	3.6	7.2	11.9	12.7	98.7

Tabela 5: Vlera mesatare e rrezatimit

Stacioni i monitorimit	1	2	3	4	5	6	7	8	9	10	11	12	Vjetore
Tirana	142.9	208.3	300	358.1	476.8	549.1	570	511	398.7	270	172.5	135.6	4093

3.1.4 Era

Ndikimi i Adriatikut eshte i dukshem sidomos per sa i perket shpejtesise se eres dhe rregjimit te saj karakteristik gjate stines se veres. Ererat jane nje element mjaft i rendesishem per gjeografine dhe agrometereologjine e rajonit. Kjo lidhet jo vetem me qarkullimin e pergjithshem t atmosferes por dhe me relieving dhe afersine e detit. Era ka karakterin e puhizes detare vecanerisht gjate sezonit te nxehte, dmth gjate dites era fryn nga deti ne toke, ndersa gjate nates nga toka ne drejtim te kundert. Drejtimi mbizoterues i eres ndryshon sipas stineve. Gjate periudhes se veres era dominuese fryn nga kuadranti i perendimit, nersa gjate periudhes se dimrit era fryn nga kuadranti i lindjes.

Tabela 6: Intensiteti i eres sipas drejtimeve

Nr	Elemente	N ^o era	Drejtimi							
			V	VL	L	JL	J	JP	P	VP
1.	Shperndarja vjetore drejtimit ne%	11.9	27.5	2.9	4.3	16.7	8.2	4.7	12.5	8.1

2.	Shpejtesia mesatare, m/s	-	3.3	2.4	3.5	4.5	6.7	5.8	4.9	4.4
----	--------------------------	---	-----	-----	-----	-----	-----	-----	-----	-----

Sic shihet periudhat pa ere perfaqesojne 11.9% te rasteve te pergjithshme te drejtimit te eres. Duke ju referuar tabelës dhe trendafilit te eres verejme qe drejtimi verior, N eshte mbizoteruesi me 27.5%, kurse vlerat minimale te rasteve jane sipas drejtimit verilindor NS me 2.9%. Mesatarja e shpejtesive sipas ketyre drejtimeve respektivisht jane: 3.3 dhe 2.4 m/s.

Nr.	Stinet	Shpejtesia m/s
1	Dimri (XII-I)	4.9
2	Pranvera (III-V)	4.4
3	Vera (VI-VIII)	3.9
4	Vjeshta (IX-XII)	4.3
5	Vjetore (I-XII)	4.4

Duke ju referuar tabelës se mesiperme shpejtesia mesatare ne stinen e dimrit eshte 4.9 m/s, ndersa mesatarja vjetore 4.4 m/s. Ererat e forta qe fryjne sipas drejtimeve veri,N e juglindje SE me shpejtesi 40-45 m/s kane ne pergjithesi kohezgatje te kufizuar, keshtu qe ndikimi I tyre ne rregjimin e valezimit eshte I vogel. Ererat me shpejtesi 10-20 m/s jo vetem kane rastisje me te madhe por kane dhe drejtim me te qendrueshem. Ne keto kushte shpejtesia e eres 20 m/s eshte perzgjedhur si shpejtesi per vleresimin e valeve maksimale llogaritesse per qellime projektimi.


3.2 Toka

Zona ne studim perfaqesohet nga tokat e hinjta. Tokat e Hinjta Kafe jane te perqendruara ne malet e uleta dhe kodrat e zones bregdetare ndermjet lartesisive 0 dhe 200 m mbi nivelin e detit (ne disa zona shtrihen deri 600 m lartesi). Duke filluar nga bregu i detit, ato shtrihen ne brendesi te territorit, ne thellesi 80 – 100 km. Formimi i tokave te Hinjta kafe eshte kushtezuar nga klima Mesdhetare kodrinore dhe fushore.

Sipas treguesve hidrotermike, ne kete brez tokesor dallohen dy zona klimatike: zona Mesdhetare fushore dhe zona mesdhetare kodrinore. Materiali primar. Tokat e Hinjta Kafe formohen ne materiale primare me nature te ndryshme, si proluviale, diluviale, aluviale dhe liqenore. Keto te fundit paraqiten me tekstore, perberje mineralogjike dhe kimike te ndryshme.

Depozitimet proluviale ndeshen mjaft rralle dhe vetem ne fundin e shpateve shume te pjerreta te kodrave. Ato jane te paseleksionuara. Depozitimet deluviale vendosen ne pjesen fundore te shpateve te pjerreta te kodrave. Kane ngjyre te hirte ne te verdhe, perberje mekanike subranore e subargjilore, si dhe permbajne karbonate. Pjesa e trashe e tyre perbehet kryesisht nga kuarci,

ndersa pjesa e imet nga hidromikat dhe mineralet e dyta te grupit te montmorilonitit. Pjesa e imet e depozitimeve subargjilore me ngjyre te kuqe perbehet nga hidromikat, caoliniti dhe oksidet e hidratuara te Fe.



3.3 Gjeomorfologjia dhe gjeologjia e zones

Qyteti i Tiranës zë vend në Ultësirën Pran-Adriatike, pikërisht në pjesën fushore më jugore të sinklinalit molasik të Tiranës. Sinklinali i Tiranës, i gjatë rreth 80.00 km dhe i gjerë 10.00-12.00km, paraqet një sinklinal asimetrik me krahun perendimor me rënie të fortë deri të përmbysur dhe krahun lindor me rënie të butë. Ndërtohet nga depozitimet molasike të Miocenit të mesëm-të sipërm dhe pjesërisht të Pliocenit në pjesën më veriore të tij. Molasa Miocenike vendoset transgresivisht dhe me mospërputhje këndore mbi strukturat karbonatiko-flishore të Zonave Jonike dhe Krutane.

3.4 Sizmiciteti

3.4.1 Tektonika rajonale dhe sizmiciteti.

Nga qyteti i Tiranës drejt Veri-Perendimit, sinklinali i Tiranës zgjerohet dhe mbulohet me sedimente aluviale Kuaternare, të cilat shtrihen horizontalisht mbi sedimentet molasike Miocen-Pliocene (Fig. 2). Sedimentet Kuaternare përfaqësohen me zhavore të ndërthurura me shtresa argjilash dhe ranash, që janë rreth 15.00-20.00m. të trasha në qytetin e Tiranës dhe drejt veriut arrijnë trashësinë rreth 200.00m pranë lumit Mat.

Sinklinali i Tiranës nga perendimi kufizon me monoklinalin e Prezës nëpërmjet një shkëputje aktive të tipit kundrahipe. Drejt lindjes zhvishen depozitimet fliore Oligocene dhe më tej ato karbonatiko-fliore që ndërtojnë antiklinalin e Dajtit (Zona e Krujës).

3.4.2 Sizmiciteti ne zonen e studimit

Qyteti i Tiranës zë vend në pjesën më Jug-Lindore fushore, 100-140 m mbi nivelin e detit. Nga lindja, jugu dhe perendimi fusha e Tiranës kufizon me kodra të uleta të ndërtuara nga sedimente të molasës Miocene. Kjo fushë që i mbivendoset sinklinalit të Tiranës paraqet një strukturë të ngjashme me grabenet, e cila kufizon nga perendimi me kundrahipe e Prezës dhe nga lindja me mbihipjen e Dajtit (Aliaj etj., 2001).

Pikërisht këtu zë vend sheshi ne studim, ku do të ngrihen Godinat. Sinklinali molasik i Tiranës që shtrihet në depozitimet Kuaternare është i mbërthyer si në morsi nga të dy anët nëpërmjet të shkëputjeve aktive mbihipëse (shih Fig. 3). Këto shkëputje aktive janë shkaktare të gjenerimit të tërmeteve të fuqishëm që kanë goditur e mund të godasin në të ardhmen zonën në afërsi të sheshit të ndërtimit.

Shkëputjet shtypëse janë aktive deri në ditët tona, çka dëshmohet nga tërmetet e gjeneruar prej tyre. Nga zona e shkëputjeve të Tiranës janë regjistruar tërmete me magnitudë deri 5.7 shkalla Rihter dhe intensitet epiqendror deri VII1/2-VIII ballë shkalla MSK-64 (Aliaj, 1967).




Fig. 3: Shkëputjet aktive që përcaktojnë skenarin e rrezikut sismik për Rajonin Tiranë-Durrës (nga Aliaj, 2000).

3.5 Karakteristika hidrogeologjike

Ne rajonin e Tirane- Durrësit shfaqen katër lloje basenesh ujembajtëse nentokesore; - Baseni karstik (struktura e Dajtit) - baseni i aluvial /poroz i kuaternarit (fusha e Tiranës dhe lugina e Erzenit) - baseni poroz i miocenit (kodrat e gropës së Tiranës) - baseni poroz i pliocenit (ultesira para Adriatike).

3.6 Ekosistemet tokësore

Një ndër karakteristikat themelore të rajoneve të zonës së projektit është mungesa e tipeve të habitateve. Kjo vërehet në një seksion edhe pse i shkurtër duke marrë në konsideratë pozicionin gjeografik dhe rrjetin hidrologjik. Në veshtrimin ekologjik, (vetëm me pak përjashtime) nuk mund të flitet për një vazhdimësi ekologjike të mirëfillte, dhe kjo për shkak të ndërhyrjeve të vazhdueshme humane si shfrytëzime të pyjeve, mbikullotje, kthimit në toka bujqësore të sipërfaqeve kullosore, zënies së tokës me ndertime për qelime banimi.

4.PERSHKRIMI I MJEDISIT EKOLOGJIK, SOCIAL DHE CILESIA E MJEDISIT TE SIPERFAQES KU PROPOZOHEM TE ZBATOHET PROJEKTI.

4.1 Pershkrim i biodiversitetit dhe cilesia e mjedisit ne zonen e projektit

Rajoni i Tiranës ka një gamë të gjerë flore dhe faune; ekzistojnë rreth 1600 specie bimësh me përqindje të lartë në raport me sipërfaqen e rajonit. Flora e zonës është e pasur me pemë të tilla si lisi, ahu, pemë halore, si dhe pemë frutore si hurma, kumbulla, shega, mana, kajsia e rrushi e shumë bimë të tjera dekorative.

4.1.1 Flora

Format jetesore mbizoterohehen nga hemikriptofitet (37 %), terofitet (28 %) dhe gjeofitet (17 %), e cila është dëshmi e hapësirave të hapura (çeltirave) dhe dendësive relativisht të ulët të kurores së bimeve drunore, shkallës së madhe të rregjimit të kateve shkurre dhe drunore. Edhe sasia e paket e fanerofiteve (13 %) është tregues jo vetëm i përfaqësimit jo të lartë të llojeve drusore, por edhe i shfrytëzimit të madh të tyre për qëllime ekonomike, e cila ka sjellë edhe proceset degraduese të bimesive në zonë. Spektri kronologjik mbizotërohet dukshëm nga format mesdhetare të lidhura ngushtë kjo me klimën e pellgut, të ndikuar edhe nga zona bregdetare megjithatë, kjo duket se është e lidhur ngushtë edhe me proceset degraduese të bimesive në zonë; në zonë gjenden shumë lloje, evropiane, euroqendrore, euroaziatike etj., të cilat tregojnë se kjo bimesi është e lidhur me llojet bimë me origjinë veriore dhe verilindore.

Sipas Flores së Shqipërisë (1988-2000), bimesia e rrethit të Tiranës përfshihet në katër zona fitoklimatike:

- ✚ te shkurreve dhe pyjeve mesdhetare,
- ✚ te dushqeve,
- ✚ te ahut, dhe te kullotave malore.

Duke filluar nga kurri i mbi Zall Dajt e deri në faqet e Bastarit, Vileze, Vileze (Liqe), Mneri i Sipërm (Pjeç, Dedaj) e poshtë tek Rreze Dushje, shtrihen një grumbull kodrash, të cilat mbulohen në pjesët e sipërme me bimesi të zonës së dushkut; pjesët me të ulëta të këtyre kodrave formojnë kryesisht shoqërimet e zonës së shkurreve mesdhetare me elemente të makjes. Ndërsa majat e larta të maleve mbulohen me atë të zonës së ahut dhe të kullotave paramalore ose malore. Vendet me të sheshta e me të pershtatshme janë zënë nga bimesia e kulturave bujqësore: drithëra, foragjere, frutikulture etj.

Zona e pyjeve dhe e shkurreve mesdhetare shtrihet në lartësi 300-600 m mbi nivelin e detit. Këto janë shoqërimet bimë të tipit të makies, perhere të blerta, si mare (*Arbutus unedo*), shqope (*Erica arborea*), mersinë (*Myrtus communis*), mrethë (*Phyllirea latifolia*), shkoze e zeze (*Carpinus orientalis*), lajthi (*Coryllus avellana*), dellinjë e kuqe dhe e zeze (*Juniperus oxycedrus*, *J. communis*), thanë (*Cornus mas*), fshikekarthe (*Colutea arborescens*), dafinë (*Laurus nobilis*) etj.

Zona e dushkajave shtrihet ne lartesine 500 (600)-1000 (1300) m, me perzierje druresh, si shparth (Quercus frainetto), qarr (Q. cerris), bunge (Q. petraea), bunge bute (Q. pubescens), frasher (Fraxinus excelsior), 12. Mersinllari et al.

Zona e ahut shtrihet ne lartesine 1000-1600 m dhe kryesohet nga ahu (Fagus sylvatica). Ahu gjendet ne kufirin me perendimor te arealit te tij, ne grumbuj te thjeshte, deri ne lartesine 1570 m, si dhe me perzierje llojesh: panje fletegjere (Acer obtusatum), melleze (Ostrya carpinifolia), bunge (Q. petraea), frasher (Fraxinus excelsior), pishe e zeze (Pinus nigra), rrobull (P. heldreichii), hartine (P. sylvestris), plep i eger (Populus alba), bli (Tilia platyphyllos) etj. Ne disa maja mbi 1'000 m, pylli i ahut eshte i paprekur, i virgjër, pothuajse natyror.

Zona e kullotave malore eshte teper e kufizuar, ne lartesine mbi 1500 m. Siperfaqe te medha dhe me vlere zene livadhet eumesofile te vendosur ne toka relativisht te thella te murrme pyjore, me Poa sp. diverse, Festuca panciciana, Cynosurus crystatus, Trifolium pratense, Phleum alpinum, Koeleria splendens, Asphodelus albus, Narcissus poeticus. Çeltirat pyjore dhe siperfaqet zhveshura gurishtore, ne pjesen me te madhe perfaqesohen nga kullota te thata me Festuca sp. diverse (F. bosniaca), Bromus sp. diverse (p.sh. B. erectus), Teucrium montanum, Stipa pennata, Thymus cherlerioides, Th. striatus. Zene vend te rendesishem livadhet gjysme te thata (meso-kserofite), me Agrostis capillaris, fier (Pteridium aquilinum), Thymus striatus etj. Ne shpatet e sheshta dhe gropat, kryesisht me drejtim verior te Malit me Gropa, relativisht me te ftohta, mbulohen nga livadhe mesofile te ftohta.



Pamje nga bimesia ne afersi te objektit qe do rikonstruktohet



Pamje nga bimesia ne afersi te objektit qe do rikonstruktohet

✚ Siperfaqja e zones se projektit ka nje mjedis te pasur me bimesi. Bimesia eshte kryesisht e kultivuar. Bimesia ne te gjithë zonen e projektit nuk ka ndonje rendesi te vecante apo status mbrojtje. Ajo ka qene me shume nje element arkitektonik i projekteve te zhvilluara. Kompozimi i Mjedisit te zones se projektit do te behet duke u mbeshtetur ne projektin e rikonstruksionit te saj.

4.1.2 Fauna

Nder llojet me vlere natyrore dhe te ruajtjes te faunes ketu vecojme amfibet, zvarraniket, shpendet dhe gjitaret. Disa prej ketyre llojeve shfaqen vetem ne zona te kufizuara. Ne zonen perreth kane folene shpende te tille si shqiponja e maleve (ne malin e Dajtit). Gjithashtu ky habitat perfaqeson nje territor te mundshem edhe per mishngrenesit si arriu i murrme e ujku, te cilet ndeshen shpesh ne zonen malore per rreth. Per sa i perket faunes ne zonen e projektit karkaterizohet nga arriu i murrem, ujku, dhelpra, derri i eger, kunadhja, shqarshi, ketri, iriqi, lakuriqi i nates (disa lloje), breshka, shqiponja, skifter (disa lloje), thelleza e malit, pellumbi i eger, qukapiku, grifsha, bilbili, si dhe shume lloje zvarranikesh dhe insektesh.

Sipas perditesimeve me Nentor 2013 te Unionit Nderkombetar per Ruajtjen e Natyres (IUCN), 109 lloje kafshesh te grupeve te ndryshme taksonomike jane konsideruar si te kercenuara, por persa i perket faunes, zona e projektit paraqet specie tipike te zonave rurale. Rriqebulli, macet e egra, dhe nuselalat jane te rralla, por mbijetojne ne disa pjese te vendit. Ka rreth 760 lloje te

kurrizoreve te gjetura deri tani ne Shqiperi. Nder keto ka mbi 350 specie zogjsh, 330 peshq te ujerave te embla dhe detare dhe 80 lloje gjitaresh. Disa prej llojeve me te rendesishme te shpendeve qe gjenden ne vend perfshijne shqiponjen e arte - te njohur si simbol kombetar te Shqiperise - specie te hutave, Capercaillie dhe shpend uji te shumte. Ekosistemet bregore paraqesin nje biodiversitet me interesant pasi ata paraqesin bimesi bregore natyrore dhe keshtu terheqin faunen qe lidhet me ekosistemet bregore.



Pamje e bimesise nga siperfaqja e zones se projektit

Tabela : Llojet kryesore te insekteve te zones ne studim

Nr	Emri shkencor	Statusi kombetar
	Rendi odonata	
1	<i>Sympetrum sanguineum</i>	
	Rendi Orthoptera	
2	<i>Gryllulus frontalis</i>	
3	<i>Calliptamus italicus</i>	
4	<i>Locusta migratoria</i>	
	Rendi Coleoptera	
5	<i>Scarabaeus sacer</i>	
6	<i>Calosoma sycophanta</i>	VU
7	<i>Gyrinus notator</i>	DD

8	<i>Anomala vitis</i>	
9	<i>Oxythorea funesta</i>	
10	<i>Cetonia aurata</i>	
11	<i>Lampyrus noctiluca</i>	
12	<i>Coccinella septempunctata</i>	
	Rendi Lepidoptera	
13	<i>Iphiclides podalirius</i>	
14	<i>Papilio machaon</i>	
15	<i>Aporia crataegi</i>	
16	<i>Pieris brassicae</i>	
17	<i>Colias crocea</i>	
18	<i>Gonepteryx Cleopatra</i>	
19	<i>Maniola jurtina</i>	
20	<i>Melanargia galathea</i>	
21	<i>Cynthia cardui</i>	
	Grupi Noturna	
22	<i>Zygaena carniolica</i>	
23	<i>Macroglossum stellatarum</i>	
24	<i>Pelosi muscerda</i>	
	Rendi Neuroptera	
25	<i>Libelloides ottomanus</i>	VU

4.1.2.1 Herpetofauna (Amfibet dhe Reptilet)

Sic shihet llojshmeria e amfibeve eshte relativisht e ulet edhe per reptile jemi ne te njejten situatë, me pak lloje te pranishme.

Tabela : Llojet kryesore te amfibeve te pranishem ne zone

Nr	Emir shkencor	Statusi Kombetar
1.	<i>Bombina variegata</i>	LR (nt)
2.	<i>Bufo bufo</i>	LR (nt)
3.	<i>Bufo viridis</i>	LR (nt)
4.	<i>Rana balcanica</i>	VU

Tabela 9: Llojet kryesore te reptileve te pranishem ne zone

	Lloji	Statusi Kombetar
1.	<i>Testudo hermanni</i>	LR (nt)
2.	<i>Anguis fragilis</i>	NE
3.	<i>Lacerta trilineata</i>	LR (lc)
4.	<i>Lacerta viridis</i>	LR (lc)
5.	<i>Podarcis muralis</i>	NE
6.	<i>Columba palmerus</i>	LR (nt)

Nga krahasimi i listes te llojeve te amfibeve e reptileve ne listen e kuqe te Shqiperise rezulton nje numer i madh llojesh qe i perkasin kategorive te llojeve te rrezikuara ne nivel kombetar.

4.1.2.2 Ornitofauna (shpendet)

Pjesa me e madhe e shpendeve te hasur ne kete territori jane dimerues dhe shtegtare, lloje qe preken me pak nga shqetesimi apo nderhyrje te tjera humane. Shpendet e perhershme dhe ata folezues te mirefillte jane dhe me te rralle. Ne menyre jo te dretperdrejte ky fakt deshmon pakesim e llojeve te cilet kane nevojte per qetesiti te plote. Shpendet e takuar i perkasin mjedisve te tipit te shkurretave, toka bujqesore te punuara apo te braktisura dhe qendrave te banuara.

Nder ta me te zakonshem jane harabeloret me perfaqesues bilbithat e trishtilat. Ne tokat bujqesore hasen me shpesh laureshat, bishtlekundesat, avdosat etj. Qendrat urbane strehojne shpend te pershtatur ndaj pranise se vazhdueshme te njeriut si dallendyshet, harabelat, kukuvajkat dhe laraskat.

4.1.2.3 Mammalofauna (gjitarët)

Nga vrojtimet ne terren dhe shqyrtimi i burimeve bibliografike te mundeshme mbi gjitaret e zones eshte bere e mundur te hartohet nje liste e llojeve te pranishem ne zonen e studimit.

Tabela :Llojet kryesore te gjitareve te pranishem ne zonen ne studim.

Nr.	Lloji	Statusi Kombetar
1.	<i>Erinaceus concolor</i>	
2.	<i>Talpa caeca</i>	
3.	<i>Crocidura leucodon</i>	
4.	<i>Pipistrellus kuhli</i>	

5.	<i>Pipistrellus pipistrellus</i>	
6.	<i>Mus musculus</i>	
7.	<i>Mus spicilegu</i>	
8.	<i>Rattus norvegicus</i>	
9.	<i>Rattus rattus</i>	
10	<i>Vulpes vulpes</i>	
11.	<i>Meles meles</i>	
12.	<i>Mustela putorius</i>	EN

Nga krahasimi i listes se mesiperme ne listen e kuqe te Shqiperise dhe anekset e disa konventave nderkombetare ne te cila Shqiperia eshte pale, rezulton se vetem nje lloj i perket kategorive te llojeve te rrezikuara ne nivel kombetar. Kjo njeherazi deshmon per rendesine e paket ne kete sspekt, te zones ne studim ne nivel kombetar. Fauna ne rajonin e Tiranes eshte e pasur me kafshe e shpende, sit e pyllit dhe te shtepise. Ne Parkun pyjor te Dajtit po edhe ne pyjet apo zabelet e tjera rriten kafshe si :lepuri, kunadhja, ujku, derri I eger, dhelpra, lundra etj. Nga shpendet e egra gjejme lloje te ndryshme zogjsh, si: harabeli, mellenja, pellumbi I eger, thelleza, kumria, laraska, sorra, skifteri, huta, bufi, bilbili, qukapiku etj. Kafshet shtepiake me te perhapura ne rrethin e Tiranes jane: lopa, buallica, delja, dhia, lepuri I bute, derri etj, ndersa shpendet me te njohura jane: pula, rosa, pata, gjeli I detit etj. Kafshet e punes jane: kali, gomari, pela, bualli, kau dhe mushka. Kali dhe gomari perdoren per ngarkim ,per mbatjen e drureve dhe prodhimeve bujqesore. Bualli dhe kau jane te afte per te terhequr parmenden.

4.2 Cilesia e mjedisit ne zonen e projektit. Drejtoria Forcës Së Posaçame Operacionale ka nje mjedis te pasur me bimesi. Bimesia eshte kryesisht e kultivuar. Ne bimesine e larte dominojne bredhi, kumbulla, ulliri, molla e eger, akacie, selvi. Barishtet jane te llojeve te ndryshme. Bimesia ne te gjithe siperfaqen e Drejtorise se Forcës Së Posaçame Operacionale nuk ka ndonje rendesi te vecante apo status mbrojtje. Ajo ka qene me shume nje element arkitektonik I projekteve te zhvilluara. Kompozimi I Mjedisit te eshte bere sa here eshte pare e arsyeshme, mbeshtetur ne projekte dhe rikonstrukcion teresor te Drejtorise se Forcës Së Posaçame Operacionale.

4.2.1 Cilesia e ujerave siperfaqesore dhe nentokesore


Shqiperia zoteron burime te bollshme te ujit. Edhe pse sasite jane te mjaftueshme per nevojat aktuale, cilesia e tyre shpesh eshte problem per shkak te ndotjes se tanishme dhe historike, sidomos ne zonat e uleta fushore ku jeton pjesa me e madhe e popullsise dhe ku zhvillohen pjesa me e madhe e aktiviteve industriale dhe bujqesore. Problem tjetër mbetet shperndarja jo e njetrajtshme e burimeve ujore ne vend. Burimet e pergjithshme, te ripërteritshme, te ujit ne Shqiperi perdoren per qellime urbane, industriale dhe bujqesore si edhe per sigurimin e prodhimit

te energjise elektrike nga hidrocentralet. Ujrat siperfaqesore dhe ato nentokesore jane te lidhur dhe varen nga njeri tjetri, por konsiderohen burime te ndara. Shqiperia ka gjashte lumenj te medhenj, ka liqene te medha nderkufitare dhe te lundrueshme, si dhe formacione te rendesishme ujembajtese, megjithate burimet ujore jane te shperndara ne menyre jo te barabarte ne vend. Ne vend ka hidrocentrale dhe rezervuare vaditjeje si dhe nje numer lagunash dhe moçalesh me vlere. Shqiperia renditet midis vendeve qe kane potenciale te medha me uje, baras me 8600 m³ per fryme ne vit.

Derdhja mesatare vjetore e ujit ne det eshte 40,5 bilion m³, e cila korrespondon me nje derdhje prej 1300 m³/sek. Reshjet jane nje burim i rendesishem i ujit me nje mesatare aktuale vjetore prej 1485 mm/vit. Burimet e ujerave siperfaqesor perdoren per prodhimin e energjise (hidro-energja), industri dhe vaditje ku formacionet ujembajtese jane shume produktive dhe furnizojne me uje te pijshem shumicen e popullsisë urbane. Uji perdoret ne te gjitha aspektet e jetes dhe eshte i rendesishem per perdoruesit publik dhe industriale. Si rrjedhoje e sistemeve te papershtatshme te monitorimit, ndryshimet e shpejta ne aktivitetet ekonomike dhe popullsi eshte e veshtire te vleresohet perdorimi i ujit ne terma te sakte.

4.3 Cilesia e ajrit ne zone

Cilesia e ajrit ne ne zonen e Projektit kondicionohen, nga dy faktore: ndertimet urbane dhe emetimet nga makinat. Grimcat e pluhurit (PM) jane nje perzierje e aerosoleve (te ngurta ose te lengeta) qe perfshin nje diapason te gjere ne madhesi dhe kompozime kimike. PM₁₀, PM_{2.5} i referohet grimcave me diameter 10 dhe 2.5 micrometer ose me te vogel, dhe emetohet direkt ne atmosfere si grimca primare ose formohet si rezultat i emisioneve te SO₂, Nox, NH₃ dhe NMVOC PM emetohen nga shume burime antropogjenike si djegia e lendes djegese , ndertimet, pluhuri natyral pezull, kripa e detit etj. PM mund te shkaktojne dhe perkeqesojne semundjet e zemres dhe mushkrive, goditje ne zemer dhe aritmi. PM mund te demtojne sistemin nervor qendror, sistemin prodhues dhe mund te shkaktojne kancer. Nje nga rezultatet e ekspozimit te PM mund te shkaktoje vdekje te parakohshme. Ne grafikun me lart jane dhene vlerat mesatare vjetore te PM₁₀ ne 3 stacione monitorimi, 2 stacione ne Tirane dhe nga 1 stacion ne Durres. Siç vihet re dhe nga grafiku kemi tejkalim te vleres kufi te BE prej 40µg/m³ ne tre stacione monitorimi ne stacionin e Agjencise Kombetare te Mjedisit, Ministrise Mjedisit nw Tiranw. Te 2 stacionet jane stacione me burim ndotje trafikun ku numri i makinave qe qarkullojne ne rruget prane stacioneve eshte shume i larte. Ne stacionin e AKM ne ndotjen e ajrit nga PM₁₀ pervec shkarkimit te automjeve ndikon edhe pluhuri i rrugeve dhe ndertimet. Vlera me e larte ditore eshte monitoruar ne muajin Prill dhe eshte 142.55 µg/m³ nga 50 µg/m³ qe eshte standarti ditor i BE.



Vlerat mesatare vjetore te PM10

Problematike mbetet numri i diteve qe tejkalon standartin ditor te BE-se ($50 \mu\text{g}/\text{m}^3$) ne 4 stacione: ne stacionin e Tirana AKM numri i diteve te tejkaluara nga 35 dite te lejuara eshte 190%, ne stacionin e Tirana MM numri i diteve te tejkaluara eshte 77%. Ne tabelen dhe grafikun e meposhtem jepen numri i diteve qe tejkalon standartin ditor te BE-se.

Tabela 17: Numri i diteve qe tejkalon standartin ditor te BE-se. *Standarti i BE-se* = $50 \mu\text{g}/\text{m}^3$.

PM10 (ditore)	Numri i diteve te tejkalar	Numri i diteve te lejuara
Tirana AKM	102	35
Tirane MM	62	35
Durres	ska tejkalm	35

4.4 Niveli i zhurmave te zones

Udhëzimi i perbashket i Ministrimit te Mjedisit, Pyjeve dhe Administrimit te Ujerave dhe Ministri i Shendetesisenr.8, date 27.11.2007 “Per nivelet kufi te zhurmavene mjedise te caktuara”, percakton vlerat kufi te zhurmave, sipas vlerave udhezuese te Organizates Boterore te Shendetesise (OBSH).

Nivelet kufi te zhurmes per mjedise te caktuara

Mjedis	Efekti kritik ne shendet	LAeq (dBA)	Koha baze (ore)	Lamax Fast (dB)
Zona me aktivitetet social-ekonomik				
Zona industriale, tregtare, qarkullimi trafiku (mjedis i jashtem dhe i brendshem)	Dentim degjimi	70	24	110
Mjedis urban				
Mjedis publike, te jashtme apo te brendshme	Dentim degjimi	85	1	110
Ceremoni, industri dhe argetime	Dentim degji i (klientet □5 here/ vit)	100	4	110
Muzike nepermjet kufjeve te degjimit	Dentim degjimi	85□4	1	110
Tinguj – zhurme impulsive nga fishekzjarret dhe armet e zjarrit	Dentim degjimi (te rriturit) Dentim degjimit (femijet)	-	-	140□2 120□2
Parqe publike				
Parqet natyrore dhe zonat e mbrojtura	Prishje e qetesise	□3		

- LAeq (dBA) = Niveli ekuivalent i matur ne shkallen A. Koha baze (ore) = Koha gjate se ciles behet matja.
- Lamax Fast (dB) = Niveli i matur ne shkallen A ne menyren fast (e shpejte)
- Shpjegime:
- □1 = Sa me e ulet qe te jete e mundur.
- □2 = Presioni zanor maksimal (Lamax, fast) matur 100 mm larg veshit.
- □3 = Zonat e jashtme te qeta duhet te mbrohen dhe raporti i zhurmes hyrese/shtese me zhurmen e fonit natyral duhet te ruhet sa me i ulet qe te jete e mundur.
- □4 = Nen kufjet e degjimit, pershtatur me vlerat e fushes se lire.

4.4 Menaxhimi i Mbetjeve Urbane

Menaxhimi i mbetjeve te ngurta urbane perben nje nga problemet me te mprehta ne Shqiperi. Politikat ne fushen e mbetjeve synojne permiresimin e administrimit te mbetjeve, me qellim qe te pakesohen rreziket qe i kanosen shendetit njerezor dhe mjedisor, duke synuar permbushjen e kerkesave te KE. Progres me i dukshem ne fushen e administrimit te mbetjeve te ngurta urbane eshte bere ne drejtim te legjislacionit. Gjate viteve 2005 – 2012 legjislacioni per menaxhimin e mbetjeve eshte permiresuar me ligje te reja, vendime dhe rregullore/udhezues qe reflektojne direktivat/vendimet e KE dhe kerkesat e Konventes se Bazelit. Strategjia Kombetare e Menaxhimit te Mbetjeve percakton drejtimin e politikës se Qeverise Shqiptare per menaxhimin e qendrueshem te mbetjeve deri ne vitin 2025 e ndare ne 3 faza operationale me nga 5 vjet secila.

Objektivat e kesaj draft strategjie jane:

- Deri ne vitin 2015 synon riciklimin/ kompostimin e 25% te mbetjeve bashkiake;
- Deri ne vitin 2020 synon te ndaloje rritjen e mbetjeve bashkiake te prodhuara; Riciklimin/kompostimin 55% te mbetjeve bashkiake;
- Deri ne 2025: Rikuperimin e energjise nga 15 % e mbetjeve bashkiake. Reduktimin e mbetjeve bashkiake ne lendfill nga 90% qe eshte aktualisht, ne rreth 30%;

Niveli i menaxhimit te mbetjeve ne Shqiperi eshte i ulet. Sherbimi i grumbullimit te mbetjeve te ngurta urbane ofrohet ne shume qytete, por jo ne zonat rurale. Mbetjet depozitohen ne vendgrumbullimet e peracktura nga bashkite. Depozitimi i tyre behet sheshet e depozitimit, te cilat nuk plotesojne parametrat e duhura per depozitim dhe trajtimin e mbetjeve. Ky menaxhim i dobët i mbetjeve permes hedhjes se tyre se bashku pa ndonje ndarje dhe trajtim ne vend- depozitim shkakton emetime te ndotesve ne ajer dhe uje.

Ne komunitet me te vogla nuk sigurohet sherbimi i mbledhjes se mbetjeve dhe individet jane pergjegjes per largimin e mbetjeve te tyre. Kjo shpesh rezulton ne hedhjen pa kriter te mbetjeve pergjate rrugeve, lumenjve dhe djegien e tyre ne mjedis te hapur. Rikuperimi, ri-perdorimi dhe riciklimi i mbetjeve eshte mjaft i kufizuar. Sistemi i grumbullimit te mbetjeve per biznesin riciklues eshte organizuar ne menyre informale. Deri tani, megjithese eshte pranuar me ligj, mbetjet e rrezikshme hidhen ne te njejtat vende me mbetjet jo te rrezikshme. Paketimi dhe etiketimi i tyre nuk vihet ne praktike, megjithese legjislacioni e parashikon kete.

4.6 Pershkrim i mjedisit social te zones

Sipas censusit të vitit 2011, në territorin e bashkisë së re Tiranë banojnë 557,422 banorë, ndërsa sipas Regjistrat Civil banojnë 757,361 banorë. Me një sipërfaqe prej 1,110.03 kilometrash katrorë, densiteti i popullsisë sipas të dhënave të Censusit është 502 banorë/ km2 ndërsa sipas Regjistrat Civil, densiteti është 682 banorë km2. Kjo bashki përbëhet nga 25 njësi administrative, të cilat janë: 11 lagjet e qytetit të Tiranës, Petrela, Farka, Dajti, Zall-Bastari, Bërzhitë, Krraba, Baldushku, Shëngjergji, Vaqarri, Kashari, Peza, Ndroqi dhe Zall Herri. Të gjitha njësitë e bashkisë së re Tiranë janë pjesë e rrethit Tiranë dhe qarkut Tiranë, me përjashtim

të qytetit të Tiranës, i cili historikisht ka qenë rreth më vete. Në territorin e kësaj bashkie ka dy qytete dhe 135 fshatra.

Qarku	Qendra e Bashkisë	Njësitë administrative përbërëse	Qytetet dhe fshatrat në përbërje të tyre	Popullsia sipas Census 2011	Popullsia sipas Regjistrat Civil	Sipërfaqja KM ²
Tiranë	Qyteti Tiranë	Tiranë	Njësia bashkiake nr.1, Njësia bashkiake nr.2, Njësia bashkiake nr.3, Njësia bashkiake nr.4, Njësia bashkiake nr.5, Njësia bashkiake nr.6, Njësia bashkiake nr.7, Njësia bashkiake nr.8, Njësia bashkiake nr.9, Njësia bashkiake nr.10, Njësia bashkiake nr.11	557,422	757,361	1110.03
		Petrelë	Fshatrat; Petrelë, Mullet, Stërmas, Picall, Shënkoll, Gurrë e Madhe, Gurrë e Vogel, Daias, Barbas, Fikas, Mangull, Qeha, Shytaj, Hekal, Kryezi, Percëllesh, Durishtë			
		Farkë	Fshatrat; Farkë e Madhe, Farkë e Vogel, Lundër, Mjull Bathore, Sauk, Selitë			
		Dajt	Fshatrat; Linzë, Shishtufinë, Tujan, Brrar, Ferraj, Priskë e Madhe, Surrel, Lanabreges, Shkallë, Qafmollë, Darshen, Selbë, Murth			
		Zall-Bastar	Fshatrat; Zall-Bastar, Bastar i Mesem, Bastar – Murriz, Vilëz, Zall-Mner, Mner i Sipërm, Bulqesh, Zall Dajt, Besh, Dajt, Shëngjin i vogel, Selitë Mali			
		Bërzhitë	Fshatrat; Ibë, Bërzhitë, Dobresh, Ibë e Poshtme, Pëllumbas, Mihajas-Cirmë, Kus, Fravesh, Killojë, Pashkashesh, Lugë-Shalqizë, Rozaverë			
		Krrabë	Qyteti Krrabë, Fshatrat; Mushqeta, Skuterë			
		Baldushk	Fshatrat; Baldushk, Mumajes, Fushas, Balshaban, Shpatë, Isufmuçaj, Mustafakoçaj, Koçaj, Kakunj, Vesqi, Parret, Shënkoll, Vrap, Shpat i sipërm			

		Shëngjergj	Fshatrat; Shëngjergj, Verri, Urë, Burimas, Shëngjin, Façesh, Bizë, Fage, Parpujë, Vakumone, Domje, Derje			
		Vaqarr	Fshatrat; Vaqarr, Allgjatë, Arbanë, Bulticë, Damjan-Fortuzaj, Gropaj, Lalm, Prush, Vishaj, Sharrë			
		Kashar	Fshatrat; Kashar, Yzberish, Mëzez, Yrshek, Katundi i Ri, Kus, Mazrek			
		Pezë	Fshatrat; Pezë e Madhe, Pezë Helmës, Pezë e Vogel, Varosh, Maknor, Dorëz, Gror, Grecë, Pajanë, Gjysyllkanë			
		Ndroq	Fshatrat; Ndroq, Zbarqe, Kërçukje, Zhurje, Lagje e re, Pinet, Sauqet, Çalabërzezë, Shesh, Grebllesh, Mënik			
		Zall-Herr	Fshatrat; Zall - Herr, Dritas, Çerkezë-Morinë, Qnam, Kallmet, Herraj, Pinar, Priskë e Vogël, Radhesh			

Tirana është bashkia më e madhe në vend si për nga popullsia, ashtu edhe nga territori. Ajo shtrihet në tri zona gjeografike të veçanta; zona bujqësore në veri, perëndim dhe jug, zona urbane e Tiranës dhe e katër komunave rrethuese, pjesërisht të urbanizuara si dhe zona e thyer malore në lindje. Tirana rezulton bashkia me normën më të lartë të urbanizimit për kilometër

katror, pas bashkisë së Durrësit. Tirana është një zonë e pasur me burime ujore, pasi përshkohet nga lumenjtë Erzen, Lumi i Tiranës dhe Lumi Tërkuzë.

Në territorin e saj ndodhen edhe një numër i konsiderueshëm liqenesh artificiale, të ndërtuara si në zonat malore, ashtu edhe në ultësirë. Në territorin e bashkisë së re gjendet edhe Parku Kombëtar i Dajtit. Qyteti i Tiranës është zemra ekonomike e Shqipërisë, me përqendrimin e numrit më të madh të bizneseve në shkallë vendi si dhe me zhvillimin e industrisë së lehtë. Fuqia ekonomike e Tiranës dallohet te sasia shumë më e lartë e kursimeve dhe e kreditit në rang kombëtar, te të ardhurat tatimore, të cilat në masë dërmuese realizohen në Tiranë si dhe te zhvillimi i sektorit të ndërtimit. Zonat bujqësore të Tiranës janë përqendruar në shkallë të gjerë te blegtoria dhe prodhimet e qumështit, por edhe tek agroturizmi. Zonat kodrinore rreth Tiranës kanë gjithashtu traditë ullirin dhe drurët frutorë. Të territorin e Tiranës gjenden disa vendburime qymyrguri të pashfrytëzuara, ndërsa aktiviteti më i përhapur sa i përket shfrytëzimit të burimeve natyrore është përpunimi i gurit për ndërtim dhe atij dekorativ.

Njesite administrative që rrethojnë Tiranën; Dajti, Farka, Vaqarri apo Kashari kanë dalë përtej klasifikimit “qendër e banuar rurale” Plotësimi i nevojave të zonave të reja urbane me kanalizime dhe ujë të pijshëm kërkon investime të konsiderueshme dhe një strategji të qartë. Mbrojtja e mjedisit dhe kufizimi i ndotjes nga gazrat e makinave konsiderohet një problem emergjent për Tiranën, në kushtet kur qyteti ka kostot më të larta të transportit me taksi apo ka hapësira shumë të pakta për qarkullimin me biçikleta. Një mendësi e re në shpërndarjen e lejeve të ndërtimit konsiderohet emergjente për Tiranën, e cila vuan nga betonizimi dhe reduktimi drastik i hapësirave të gjelbra. Zgjerimi i qytetit drejt njesive administrative përreth krijon mundësi për të shfryrë presionin për leje ndërtimi ndërtim përmes zhvillimit të hapësirave të reja urbane. Hartimi i planeve urbanistike tërësore në përputhje me kuadrin ligjor aktual të konsultimit publik si dhe transparenca e planeve urbanistike mund të ndihmojë në mbrojtjen e qytetit nga ndërtimet abuzive me apo pa leje.

4.6.2 Punesimi dhe niveli i jeteses

Sipas te dhenave statistike te marra nga studimi “Living Standards Measurements Survey in 2002 (LSMS)”, niveli me i ulet i jeteses haset ne zonat rurale, familjet e te papuneve dhe familjet me shume femije. Puna ne zonat fshatare paguhet shume me pak se sa ne sektoret e tjere te ekonomise. *Niveli i jeteses ne zonen e Linzes dhe ne Njesine Administrative Dajt eshte i zhvilluar.*

4.6.4 Infrastruktura e zones se projektit

Infrastruktura ekzistuese rrugore e eshte e zhvilluar. Zona i perket nje zone urbane te zhvilluar. Per ndertimin e objektit do te shfrytezohen rruget ekzistuese, nuk do te kete hapje rruges te reja pasi projekti i perket nje zone urbane mjaft te zhvilluar.

4.6.4.1 Infrastruktura fizike

Infrastruktura ekzistuese rrugore e cila shtrihet ne pjesen e madhe te zones ku ndertohet objekti eshte e favorshme per ndertimin e tij duke ndikuar ndjeshem ne koston e ndertimit. Gjithashtu ndikim pozitiv do te kete dhe per mjedisin, pasi nuk do te kete nevojte per hapje te rrugeve te reja, pra eleminon ndimin ne mjedis .



Pamje e infrastruktures brenda zones se projektit

4.6.4.2 Infrastruktura sociale

Arsimimi

Kjo njësi administrative ka gjithsej 1387 nxënës banues dhe 1268 nxënës frekuentues të shkollave 9-vjeçare dhe të mesme të bashkuar të kësaj njësie. Megjithëqë shkollat ekzistuese të kësaj njësie administrative nuk paraqesin probleme me mbipopullimin, zona e urbanizuar me dendësi relativisht të larta pranë kopështit botanik gjendet e distancuar nga infrastruktura ekzistuese arsimore.

Mjetet e komunikimit

Mjetet e komunikimit jane te shumellojshme: sherbimet,gazetat kryesore Shoqerite Telekom Vodafon dhe rrjeti Eagle Mobile, TV etj.

Sherbimi shendetsore

Ne njesine administrative Dajt jane ne funksion disa qendra shendetsore primare. Ne perberje te ketyre qendrave ka mjekeve te familjes, ndersa disa prej tyre kane edhe mjeke specialiste, konsulente per grate dhe femijet, si dhe staf mbeshtetes. Ne territorin e bashkise ndodhen disa farmaci dhe klinika private qe ofrojne sherbimin e kujdesit dentar privat. Konstatohet se nje pjese e madhe e banoreve te kesaj bashkie, per shkak te afersise, i drejtohet spitaleve te kryeqytetit per te marre kujdes shendetsor.

➤ **5. INFORMACION PER PRANINE E BURIMEVE UJORE NE SIPERFAQEN E KERKUAR NGA PROJEKTI DHE NE AFERSI TE SAJ.**

Tirana shtrihet mbi shtresëzime dhe xhepa kuaternari. Ato janë shtresëzime aluviale përgjatë rrjedhës së dy lumenjve kryesorë. Disa brezare më të vjetra lumore janë të përbëra nga zhavorr, gurë ranor e baltë argjilore. Tirana shtrihet në një shtresë ujë-mbajtëse me përmbajtje poroze, që është pjesërisht arteziane. Uji i nëndheshëm gjendet kryesisht në pjesën perëndimore të qytetit dhe përdoret si për furnizimin publik me ujë dhe për përdorime private, veçanërisht për industrinë. Puset janë mjaft të cekët, rreth 15 metra të thellë, gjë që i ekspozon ato më shumë ndaj ndotjes nga aktivitetet në sipërfaqe. Të territorin e Tiranës gjenden disa vendburime qymyrguri të pashfrytëzuara, ndërsa aktiviteti më i përhapur sa i përket shfrytëzimit të burimeve natyrore është përpunimi i gurit për ndërtim dhe atij dekorativ.

Ne rajonin e Tiranës, temperatura e ujit është me e lartë në muajt e verës (Korrik - Gusht), ku edhe sasia e energjisë diellore është me e madhe, ndërsa temperatura me e ulët është në dimër, në muajin Shkurt. Përsa i përket vecorive sezonale mund të pohojmë që gjysma e ngrohtë e vitit prill-shtator karakterizohet nga temperatura mesatare 20.6°C ndërsa gjysma e ftohtë 12.4°C. Ecuria vjetore e temperaturave maksimale absolute të ajrit është e njëjte me atë të temperaturave mesatare, pra me një minimum në janar dhe maksimum në korrik ose gusht. Temperaturat maksimale absolute >30°C fillojnë të regjistrohen që nga muaji maj dhe vazhdojnë deri në shtator.

Temperatura maksimale absolute me e lartë e vrojtuar është 38.6°C në Korrik (viti 1988). Një nga treguesit më të rëndësishëm për të karakterizuar temperaturat maksimale të ajrit është dhe mesatarja maksimale, vlerat e së cilës variojnë nga 12°C në janar deri në 27.8°C në korrik. Në këto zone vrojtohen vlera jo shumë të ulta të temperaturës minimale absolute. Shfaqja e vlerave negative të këtij treguesi nuk është ngjarje e rrallë.

Ne zonën e projektit nuk kemi prani të burimeve ujore që do të ndikohen nga zbatimi i projektit.

➤ **6. NDIKIMET E MUNDSHME NEGATIVE NE MJEDIS TE PROJEKTIT, PERFSHIRE NDIKIMET NE BIODIVERSITET, UJE, TOKE DHE AJER;**

Vleresimet e ndikimeve ne mjedis

Para se të kalojmë tek vlerësimi dhe identifikimi i ndikimeve në mjedis, ne shoqëri dhe ekonomi është e domosdoshme të njohim natyrën e ndikimit/eve. Ndikimet mjedisore, sociale e ekonomike të një projekti janë këto ndryshime rezultante në parametrat mjedisore, sociale e ekonomike, në hapësirë dhe kohë, karahasuar me çfarë mund të ketë patur ndodhur kur projekti nuk do të ishte marrë. Parametrat janë të çdo tipi të receptorëve mjedisore, sociale e ekonomike, shënuar mëparë: si cilësia e ajrit, cilësia e ujit, zhurmat, vibrimet, punësimi etj.

Ndikimet ne mjedis ne pergjithesi trajtohen si ndikime:

1. Gjate fazes ndertimit
2. Gjate fazes se funksionimit

6.1 Ndikime ne atmosfere

Gjate fazes se ndertimit te objektit, procesi i punes do perfsheje dhe germimet te cilat mund te sjellin emetim pluhurash ne atmosfere. Shoqeria sipermarrese e punimeve do te zbatoje masat e percaktuara ne raportin e VNM-se ne menyre qe emetimi i pluhurit ne atmosfere te jete sa me i vogel. Ky ndikim do te shfaqet vetem gjate fazes se ndertimit te objektit. Gazet e demshme te cliruara nga djegia e karburantit te automjeteve mund te krijohen gjate fazes se ndertimit te objektit por gjithnje pa i kaluar limitet e lejuara, nderkohe qe gjate shfrytezimit te objektit nuk do te kete emetime gazesh te demshme dhe theksojme se keto burime gjeneruese te jane te pastra. Gjate fazes se funksionimit te objektit nuk do te kete asnje ndikim ne mjedis.

6.2 Ndikimi ne toke dhe uje

Gjate fazes se ndertimit. Nga studimi gjeologjik eshte konstatuar qe zona perbehet nga formacione te qendrueshme: Ndikimi i punimeve per ndertimin e objektit dhe permasat e nderhyrjeve do te jene minimale, por megjithate keto inerte qe do te dalin gjate punimeve do te sistemohen dhe do te dergohen ne venddepozitim e miratuar nga bashkia Tirane . *Mund te kete derdhje aksidentale te karburanteve te automjeteve gjate ndertimit te objektit, por me ndikim te perkohshem.* Toka eshte element qe peson ndryshime gjate zbatimit te proj

ektit (gjate ndertimit te objektit sepse:

- Do te germohet material por do te rikthehet ne fazen e rehabilitimit te terrenit.
- Do te kryhen punime betoni (M 150, M200 dhe M250).
- Keto punime, te cilesuar me lart shoqerohen me nje volum te vogel germimesh.
- Do te behet rehabilitimi i zones se prekur nga projekti.

Nuk pritet ndotje e tokes dhe ujit, meqenese kjo gje mund te parandalohet. Mund te shkaktohet nje rritje e vogel e ndotjes se ujit sipërfaqesor dhe dheut si pasoje e ndonje derdhjeje aksidentale te lengjeve apo rrjedhjeve te ndotura si dhe perkeqesimi si pasoje e cilesise se ujerave sipërfaqesor ne momentin e ndertimit. Ndotje te ujerave nentokesore nuk do te kete. Gjate fazes se Ndertimit , mund te ndodhe qe te kete shpellarje te lendes se pare nga shirat.

Keshillohet qe lendet e para te vendosen ne vende te thata dhe te mbuluara ne menyre qe te mos kete ndotje te ujerave sipërfaqesore. Gjithashtu ndotje mund te kete dhe gjate germimeve per krijimin e vaskes per mbledhjen e ujit. Por ndotja do te jete e perkoheshme, vetem gjate punimeve. Gjate fazes se ndertimit te objektit, do te kemi sjelljen e lendes se pare si cemento, koll etj. Per te parandaluar ndotjen e tokes pjesa e llacit dhe te gjitha do te behen me makineri bashkekohore dhe automatike.

6.3 Ndikimi ne regjimin dhe perdorimin e ujerave

Realizimi i projektit per objektin e caktuar nuk do te ndikoj ne ujerat sipërfaqesor dhe nentokesor te zones. Projekti nuk do te ndikoj negativisht ne regjimin dhe perdorimin e ujit.

6.4 Ndikimi ne balancen e ekosistemit.

Nuk do te kete ndikime serioze ne ekosistem pasi ndertimet dhe rikonstruksionet i perkasin objekteve ekzistuese.

6.5 Ndikimi ne perberjen e flores dhe faunes

Nga zbatimi i projektit nuk do te kete ndikime ne flore. Gjate kryerjes se punimeve per ndertimin e objektit nuk do te kete prerje te pemeve te larta. Do te demtohet vetem bari dhe bimet dekorative te mbjella nga njeriu dhe qe do mbillen menjehere pas perfundimit te punimeve te objektit. Ne projekt eshte parashikuar rehabilitimi i sipërfaqes se prekur nga punimet e ndertimit. Gjate shfrytezimit nuk do te kete asnje ndikim ne mjedis, ne flore. Zbatimi i projektit dhe zhvillimi i tij nuk ndikojne negativisht ne humbjen dhe demtimin e habitateve si dhe te specieve shtazore. Mund te kete ndikim ne faunen nentokesore (insekte etj) gjate fazes se ndertimit te objektit por jo ndikime te konsiderueshme per nje projekt me nje rendesi te tille.

6.6 Ndikimi ne zhurma dhe vibrimet

Gjate fazes se ndertimit zhurmat dhe vibrimet jane nje ndikim i pashmangshem ne mjedisin ku do te kryhet nderhyrja. Zhurma mund te vijne nga perdorimi i makinerive ne ambientin e punes. Ne rastin tone zhurmat do te jene si pasoje e mjeteve te renda, gjate fazes se ndertimit, gjate germimit, transportit (ngarkim shkarkim). Keto zhurma do te jene te perkohshme dhe nuk do te kete akumulim te saj tek njeriu. Punonjesit do te jene me te prekshmit nga keto zhurma, per te cilet do te kerkohet zbatimi i masave te sigurimit teknik ne pune. Te shkaktuara gjate kalimit te mjeteve te ndertimit te tonazhit te larte: Do te ndihen vibrime ne mjedisin aty prane.

Do të shkatohen vibrime dhe nga vibriatori i llacit që do të perdoret për të realizuar shpërndarjen e llacit mirë neper kalëpin e kollonave, etj. Gjate ndertimit do të ndikohet vetëm në jetën e punonjesve të ndertimit dhe si dhe në mjedisin e banuar aty pranë sheshit të ndertimit, por ndikimi do të jetë në nivele të ulta. Zhurma e krijuar nuk do të jetë e ndryshme nga zhurma e përgjithshme e krijuar nga punimet e ndertimeve civile. Zhurma pritet të jetë e moderuar por e perkohshme pasi kontraktuesit aplikojnë teknologjinë më të fundit për kontrollin e uljeve të vibrimeve dhe zhurmave në mënyrë të konsiderueshme pa rritje të shpenzimeve operative. Matjet shkencore kanë treguar një ulje prej të paktën 35-40% të nivelit të impaktit të vibrimeve. Niveli i zhurmave i parashikuar gjatë kësaj faze është e pranueshme dhe konform normave në fuqi.

6.7 Ndikimi në erozion

Realizimi i projektit nuk do të ketë ndikime në levizjen apo zhvendosjen e popullatës së zonës. Nga raporti i objektit si planvendosje me komunitetin ben që vepra të mos influencojë negativisht në demografikë komunitare. Studimi dhe realizimi i tij ka si objektiv kryesor ndertimin e objektit që të ndikojë pozitivisht në përmirësimin e kushteve të jetesës të punonjesve dhe gjithashtu do të ndikojë pozitivisht tek komuniteti i zonës, duke ju krijuar mundësi punësimi.

Gjatë ndertimit të objektit një pjesë e popullsisë do të punësohen duke ndikuar në rritjen e të ardhurave të tyre. Infrastruktura brenda Drejtorisë së Forcës Së Posaçëme Operacionale do të përmirësohet. Duke qenë se objekti është në afërsi me zonat e banuara do të merren masa për mos prishjen e qetesise së banoreve nga zhurma gjatë punimeve për ndertimin e objektit. Situata pak shqetësuese për banoret që jetojnë në afërsi të zonës së projektit është krijimi i problemeve në qarkullim duke qenë se do të rritet numri i makinerive të mëdha në atë zonë, që transportojnë materiale për ndertimin e objektit. Gjatë fazës së shfrytëzimit nuk do të ketë asnjë ndikim në mjedisin human duke qenë se objekti është ekzistues dhe projekti përshin vetëm rikonstrukcion.

6.8 Ndikimi në mjedisin human

I vetmi ndikim në shëndetin e njerezve është ai i situatave që mund të shkaktohen gjatë zbatimeve të punimeve për qëllimin e objektit. Zbatimi i rregullave të sigurimit teknik e minimizon këtë impakt. Personeli i cili do të punojë gjatë zbatimit të projektit do të jetë i kualifikuar dhe i trajnuar si për sigurimin teknik ashtu edhe për rreziqet e mundshme. Ndikim negativ në shëndetin gjatë funksionimit të objektit nuk do të ketë. Ndikimet në shëndetin human gjatë shfrytëzimit do të jenë pozitive pasi do të përmirësohen kushtet jetësore brenda çdo godine.

6.12 Ndikimet e emtimeve kimike ne toke dhe rrethimet

Realizimi i projektit nuk ka ndikime negative afatgjata ne aspektin e ndikimeve kimike dhe depozitimeve ne token dhe rrethinat ku do te zhvillohet projekti. Gjate fazes se ndertimit si zbatimit te punimeve mund te kete derdhje aksidentale te karburanteve te automjeteve megjithate firma zbatuese merr persiper shmangien e tyre ne vend. Ne rastet e gomave te makinerive te demtuara apo baterive, edhe pse do jene ne sasi te vogla, shoqeria sipermarrëse e zbatimit te punimeve do te bëjë dorëzimin e tyre në përputhje me standardet e legjislacionit shqiptar në shoqëritë e licencuara nga shteti shqiptar për grumbullimin e tyre.

6.10 Ndikimi ne habitate, objektet me status te cilesuar

Nuk ka ndikim ne habitate apo objekte me status te cilesuar. Zona e projektit i perket nje zone urbane te zhvilluar dhe nje objekti ekzistues.

6.11 Ndikim ne perdorimin e tokes dhe burimeve

Realizimi i projektit nuk do te kete ndikime negative ne cilesine e tokave bujqesore te zones, gjithashtu dhe burimet ujore do te qendrojne te paprekura.

6.12 Ndikim ne kime dhe ajer

Ne terma te shkurtuar dhe te faktit qe ndikimi do te jete lokal, ndotja e ajrit do te kuptojme prishjen e cilesise se ajrit perreth zones nga punimet e ndertimit sic jane pluhurat nga procesi i germimeve dhe pergatitjes se betonit per bazamentin, te cilat do te shtohen me shume gjate perdorimit te punimeve me pajisje ne procese me materiale te thata, ne periudhen e pranveres, veres dhe vjeshtes. Ky proces do te ndikoj gjate procesit te ndertimit te bazamenteve, dhe objektit ne teresi.

Ambientet brenda dhe jashte zones se projektit do te lahën me uje pas cdo procesi pune, per te eliminuar ndotjen e ajrit. Gjate ndertimit do te kete emetime gazesh nga disa veprimtari:

- Mjetet e transportit qe sjellin lenden e pare
- Mjetet e marrin mbetjet e gjeneruara nga aktiviteti,
- Mjetet e punonjesve dhe vizitoreve. etj

6.13 Ndikimi ne turizem

Pas ndertimit ndikimi ne turizem shoqerohet me permiresimin e infrastruktures dhe sherbimeve te qytetit.

6.14 Ndikimi ne ekonomi

Projekti do te krijoj mundesine e punesimit te banoreve duke ndikuar direkt ne rritjen ekonomike te tyre dhe indirekt ne rritjen e ekonomise se bashkise Tirane. Ndikimi i ketij aktiviteti ne rang lokal do te jete pozitive dhe me impakt te rendesishem per komunitetin e zones perreth. Gjithashtu ndikimi i ketij aktiviteti do jete dhe rajonal, duke u punesuar specialist te fushave perkatese.

6.15 Ndikim ne shendetin human

I vetmi ndikim ne shendetin e njerezve (per punonjesit) eshte ai i situatave jonormale qe mund te shkaktohen gjate ndertimit te objektit. Zbatimi i rregullave te sigurimit teknik e minimizon kete impakt. Personeli i cili do te punoje gjate shfrytezimit te vepres do te jete i kualifikuar dhe i trajnuar si per sigurimin teknik ashtu edhe per rreziqet e mundshme. Nuk do te kete ndikim ne shendetin e njerezve gjate ndertimi te objektit dhe as gjate funksionimit te objektit .

6.17 Ndikime ne peisazh dhe ne trashegimin kulturore estetike

Peisazhi nuk do te demtohet nga ndertimi i objektit sepse nderhyrja do te behet ne harmoni me mjedisin ekzistues. Zona ne studim nuk mbart vlera kulturore te vecanta.

6.18 Ndikimet e projekteve te tjera qe shoqerojne projektin

Infrastruktura e projektuar dhe ajo egzistuese per ndertimin e objektit do te projektohen ne lidhje me kushtet klimaitike dhe mjedisore te zones.

- Te gjitha ndertesat apo strukturat e vendosura ne lartesi duhet te pajisen me rrufepritesa statike ne menyre qe te presin rrufete e rena ne kohe shtrengatash.

6.19 Tabela permbledhese e ndikimeve negative dhe positive ne mjedis

Lloji i ndikimit ne toke	Identifikimi i ndikimit			
	Gjate ndertimit		Gjate shfrytezimit	
	Po	Jo	Po	Jo
Humbje e tokes per kullote.		X		X
Ndryshime topografike te terrenit.	X			X
Prishja e tokes bujqesore.		X		X
Ndotja e tokes nga rrjedhje.		X		X
Ndotja e tokes nga mbetjet e ngurta.		X		X
Ndotja e tokes nga depozitimet e llumrave.		X		X
Lloji i ndikimit ne cilesine e ajrit	Identifikimi i ndikimit			
	Gjate ndertimit		Gjate shfrytezimit	

	Po	Jo	Po	Jo
Prodhimi i pluhurit.	X			X
Ndotja nga hidrokarburet, plumbi dhe aerosolet.		X		X
Ndotja nga monoksidi karbonit dhe dioksidit te squfurit (co, so2).		X		X
Lloji i ndikimit ne floren dhe faunen	Identifikimi i ndikimit			
	Gjate ndertimit		Gjate shfrytezimit	
	Po	Jo	Po	Jo
Shkaterrimi i rendesishem i habitave natyrore.		X		X
Rrezikimi i nderhyrjes ne bimet e ujit.		X		X
Ndertimi i rrugeve te reja qe kalojne permes zones se virgjer.		X		X
Percarje apo izolim te habitave te egra.		X		X
Interference midis rruges natyrale te emigrimit te sisorve.		X		X
Lloji i ndikimit ne uje	Identifikimi i ndikimit			
	Gjate ndertimit		Gjate shfrytezimit	
	Po	Jo	Po	Jo
Trajtimi i ujrave te ndotur.		X		X
Ndotja e ujit prej pluhurit, plumbit, derdhjeve aksidentale dhe substancave te tjera.		X		X
Impakti sekondar ne ndotjen e ujit per tokat bujqesore, ujrat nentokesore etj.		X		X
Modifikim ne drenazhimin e ujrave natyrale.		X		X
Ndotja e ujrave siperfaqesore dhe nentokesore nga llumrat.		X		X
Lloji i ndikimit ne ndotjen nga	Identifikimi i ndikimit			
	Gjate ndertimit		Gjate shfrytezimit	
	Po	Jo	Po	Jo
Rritja e nivelit egzistues te zhurmave.	X			X

Rritja e nivelit te zhurmave si rezultat i aktivitetit dhe makinave.	X			X
Rritja e nivelit te zhurmave per njerezit.	X			X
Nivel me i larte i zhurmave per kafshet.	X			X
Lloji i ndikimit ne perfitimin e tokes	Identifikimi i ndikimit			
	Gjate ndertimit		Gjate shfrytezimit	
	Po	Jo	Po	Jo
Shkaterrim objektesh.		X		X
Ndryshime te rendesishme ne programet per te ardhmen e perdorimit te tokes.		X		X
Ndertime objektesh.	X			X
Shpronsime te tokes.		X		X
Lloji i ndikimit ne interesin publik (infrastruktura)	Gjate ndertimit		Gjate shfrytezimit	
	Po	Jo	Po	Jo
Sistemi i ujesjellesit do te kete apo jo nevojte per ndryshim ne kete fushe te interesit publik.		X		X
Energji elektrike.		X		X
Sistemin e komunikacionit.		X		X
Sistemin e kanalizimit te ujrave te zeza dhe te bardha.		X		X
Mbetjet e ngurta dhe depozitimi i tyre.	X			X
Lloji i ndikimit ne shendetin e njerezve	Identifikimi i ndikimit			
	Gjate ndertimit		Gjate shfrytezimit	
	Po	Jo	Po	Jo
Krijimi i cfaredo rreziku apo mundesie per demtimin e shendetit te njerezve.		X		X
Krijimi i raportit te njerezve me rreziqet e mundshme per demtimin e shendetit te tyre.		X		X
Lloji i ndikimit ne qarkullim dhe transport	Identifikimi i ndikimit			
	Gjate ndertimit		Gjate shfrytezimit	
	Po	Jo	Po	Jo

7. PERSHKRIMI PER SHKARKIMET E MUNDSHME NE MJEDIS, TE TILLA SI: UJERA TE NDOTURA, GAZE DHE PLUHUR, ZHURMA, VIBRIME, SI DHE PER PRODHIMIN E MBETJEVE

7.1 Trajtimi i ujerave te ndotura dhe largimi i mbetjeve

Per objektin e projektimi ujerat e ndotur do te derdhen ne rrjetin e kanalizimeve i kanalizimeve te ujerave te bardha dhe te zeza te qyetetit te Tiranes. Mbetjet e ngurta do te largohen dhe do te dergohen ne venddepozitimin e miratuar nga bashkia Tirane. Gjatë kryerjes së punimeve do të sigurohet një mirëmbajtje e mirë e sistemeve të drenazhimit dhe e sistemeve të furnizimit me ujë. Në përputhjen me kërkesat teknologjike dhe me pajisje të përshtatshme për grumbullimin dhe ruajtjen (enë metalike, kontejner metalike me kapak, çanta për mbledhjen e plastikës), ne do të sigurohemi që mbeturinat, mbetjet e rrezikshme ose materiale të tjera të dëmshme për mjedisin (derdhjet e naftës, karburante, kimikate, etj.), të përdorura ose të prodhuara gjatë kryerjes së, nuk do të hyjnë në ujësjellësa, ujra sipërfaqësore ose ujra nëntokësore.

- Llojet e mbeturinave do të mblidhen në mënyrë të diferencuar në kazanët përkatës, përgjatë rrugës. Koshat / kontejnerët do të jenë në dispozicion në sasi të mjaftueshme. Llojet e ndryshme të mbeturinave nuk do të përzihen me kategoritë e tjera të mbeturinave - Kompania do të përmbush kërkesat e hapësirës së posaçme për ruajtjen e mbeturinave dhe kontejnerëve të magazinimit.

- Regjistrimi i sasisë së mbeturinave (duke përfshirë llojet e mbeturinave, sasi, kompanitë e transportit, destinacionet përfundimtare ose destinacionin e përpunimit, të licencuara nga kompanitë e transportit të transportit të angazhuar dhe objektet e përpunimit / depozitimit dhe informacione dhe dokumente të tjera të rëndësishme). Do të mbahet rregjistër mbi sasinë e mbeturinave të krijuara dhe të depozituara/në vendndodhjen e zonës së depozitimit. Shënimet do të mbahen nga specialistët e mjedisit të kontraktorit.

7.2 Klasifikimi i mbetjeve, mbetjet e rrezikshme

Bazuar ne Vendimin e Keshillit te Ministrave nr.99, datë 18.2.2005 "Për Miratimin E Katalogut Shqiptar Të Klasifikimit Të Mbetjeve". **Bazuar ne klasifikimin e mbetjeve, gjate rikonstruksionit dhe ndertimit te objekteve do te kete kete mbetje nga ndertimet (përfshire dhera të gërmuara nga zona të kontaminuara).** Mbetje te tille do te kete vetem gjate fazes se ndertimit te objektit, domethene do te kete volume dherash te germuara dhe mbetje inertesh nga prishja e suvave ekzistuese. Mbetje të rrezikshme jane mbetjet: "eksplozive", substancat dhe preparatet të cilat mund të shpërthejnë nën efektin e flakës ose të cilat janë më të ndjeshme nga goditja apo fërkimi dhe "oksiduese", substancat dhe preparatet të cilat kanë reaksione të fuqishme ekzotermioke kur bien në kontakt me substanca të tjera, veçanërisht me substanca të djegshme. "shumë të djegshme": mbetje vajrash dhe mbetje te karburanteve te lëngshme, te rrezikshme": substancat dhe preparatet, të cilat nëse thithen

nëpërmjet frymëmarrjes, injektohen ose penetrojnë në lëkurë mund të shkaktojnë rrezik të kufizuar të shëndetit. **Gjate zbatimit të projektit nuk nevojiten substanca të tilla, pra nuk do të ketë asnjë mbetje të rrezikshme në territorin ku do të zhvillohen punimet.**

Bazuar në vendimin e KM nr. 371, datë 11.6.2014, "Për miratimin e rregullave për dorëzimin e mbetjeve të rrezikshme dhe të dokumentit të dorëzimit të tyre" në rastin e rikonstruksioneve të objekteve nuk do të ketë mbetje të tilla.

7.3 Mbetjet E Ngurta

Gjate aktivitetit për realizimin e projektit do të ketë krijim të materialit të ngurtë të germuar por jo të demshme. Vëmendje kryesore gjatë këtyre punimeve duhet të tregohet në dy aspekte

- 1) sistemimi i dherave të krijuar nga këto punime,
- 2) sistemimi i materialeve të ndryshme gjatë ndertimit.

- ❖ Pra, mund të themi se nga ky aktivitet nuk pritet të ketë ndikim mjedisor të matshëm pasi:
 - Nuk ka prodhim të mbetjeve të rrezikshme.
 - Nuk shkakton ndotje të tokës me shkarkime të ndryshme të lëngëta apo të ngurta.
 - Nuk ka shkarkime në ajër të gazrave apo tymrave përveç makinerive gjatë ndertimit të objektit.
 - Zhurmat në mjediset e punës do të jenë brenda normës shëndetësore të lejuar, dhe për pasojë as zhurmat në mjediset e jashtme nuk pritet të kenë ndikim në popullatën përreth.
 - Nuk ka çlirim të aromave të ndryshme etj.
 - Ka vlera normale të temperaturës dhe të lagështisë në mjediset e punës.
 - Janë parashikuar marrja e të gjitha masave për mbrojtjen në punë dhe masat për evitimin e rrezikut të zjarrit.

7.4 Pluhuri

Në këtë kompleks do të jete prezent e ekzistenca e pluhurit, sepse do të ketë operacione pune që do të shkaktojnë pluhura sic janë transporti i materialeve të ndertimit. **Ambientet brenda dhe jashtë zones së projektit do të lagon me ujë pas çdo procesi pune gjithashtu dhe gjatë transportit të inerteve dhe do të jenë të mbuluara në raste të nevojshme .**

7.5 Trajtimi i vajrave të përdorur

Sipas Vendimit të Keshillit të Ministrave Nr. 765, datë 7.11.2012 "për miratimin e rregullave për grumbullimin e diferencuar dhe trajtimin e vajrave të përdorura" përshin të gjitha vajrat lubrifikante, të lëngshme apo gjysmë të lëngshme, me bazë minerale a sintetike, të cilat janë kthyer në të pavlefshme për qëllimin për të cilin janë prodhuar, pasi janë përdorur nga çdo lloj motori, pajisjeje e makinerie që punon me to, si dhe nëse kanë skaduar në magazina apo pika shitjeje.

Vajrat e përdorura (VP) përfshijnë:

- a) vajrat e përdorura në motorët me djegie të brendshme;
- b) vajrat e përdorura të kutive të shpejtësive (grasot);
- c) vajrat e përdorura lubrifikante minerale;
- d) vajrat e përdorura hidraulike;
- dh) mbetjet vajore nga depozitat;
- e) përzierjet vaj - ujë;
- ë) emulsionet.

Gjate zbatimit të projektit nuk do të kete ndotje nga vajrat lubrifikante, të lëngshme apo gjysmë të lëngshme, me bazë minerale a sintetike, të cilat janë kthyer në të pavlefshme për qëllimin për të cilin janë prodhuar, pasi janë përdorur nga çdo lloj motori, paisjeje e makinerie që punon me to, si dhe nëse kanë skaduar në magazina apo pika shitjeje. Nuk do të kete derdhje të vajrave të përdorur, të dëmshme në tokë, si dhe shkarkim të pakontrolluar të mbetjeve që rezultojnë nga përpunimi i tyre. Investitori që në fillimin e punimeve tregohet i gatshëm me masat që do të marri në rast se do ndodhi ndonjë rast i tillë, i derdhjes së vajit të makinerive në tokë.

7.6 Mbetjet inerte

Sipas Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 575, datë 24.6.2015 "Për miratimin e kërkesave për menaxhimin e mbetjeve inerte" Mbetjet inerte me mundësi ricikluese do të grumbullohen dhe do të dorëzohen tek operatorët, të cilët janë të pajisur me leje mjedisore, pra në kompani ricikluese. Shoqëria investitore e cila kryen punime për objektin, do të ruajë, t'i transportojë dhe t'i dorëzojë mbetjet inerte në venddepozitimin e përkohshëm sipas përcaktimeve të vendimit nr. 371, datë 11.6.2014, të Këshillit të Ministrave.

7.7 Menaxhimi i mbetjeve nga gomat e përdorura

Vendim i KM nr. 652, datë 14.9.2016, "Për rregullat dhe kriteret për menaxhimin e mbetjeve nga gomat e përdorura" nenkupton menaxhimin e mbetjeve nga gomat e përdorura, rregullat dhe kriteret që përfshijnë mbledhjen/grumbullimin, transportimin, ruajtjen/ magazinimin dhe trajtimin e gomave të përdorura në mënyrë të tillë që të sigurohet mbrojtja e shëndetit të njeriut dhe e mjedisit. Në kuptim të këtij vendimi me termat e mëposhtëm nënkuptohet: "Grumbullues", personi që kryen grumbullimin e mbetjeve të gomave të përdorura. "Magazinues", personi që kryen ruajtjen e përkohshme të mbetjeve. "Trajtues", personi që kryen trajtimin e mbetjeve. **Gjate zbatimit të projektit, gomat jashtë përdorimit nuk do të digjen apo të hidhen por do të grumbullohen dhe transportohen, do të magazinohen në ambiente të caktuara (shoqëri të licensuara për grumbullimin e tyre) dhe do të trajtohen si goma të përdorura në mënyrë të tillë që të sigurohet mbrojtja e shëndetit të njeriut dhe e mjedisit përreth ku ndertohet objekti. I gjithë procesi i grumbullimit, transportimit dhe magazinimit do të behet sipas rregullave dhe procedurave të shoqërisë së licensuar për grumbullimin e tyre.**

7.8 Baterite, akumulatorete dhe mbetjet e tyre

Qellimi i Vendimit te KM, Nr.866, Dt. 04.12.2012 "Per baterite, akumulatorete dhe mbetjet e tyre" eshte mbrojtja, ruajtja e permiresimi i cilesise se mjedisit, si dhe mbrojtja e shendetit publik, permes minimizimit te ndikimeve negative nga baterite, akumulatorete dhe mbetjet e tyre. Gjate fazes se ndertimit te objektit nuk do te kete probleme dhe ndotje nga baterite dhe akumulatorete e tyre.

7.9 Transferimi i mbetjeve jo te rrezikshme

Vendim i KM, Nr.229, Dt :23.04.2014 "Per miratimin e rregullave per transferimin e mbetjeve jo te rrezikshme dhe informacionit qe duhet te perfshihet ne dokumentin e transferimit". Dokumenti i transferimit te mbetjeve jo te rrezikshme plotesohet per te gjitha hallkat qe ndiqen per transferimin e mbetjeve qe nga krijimi deri ne destinacionin perfundimtar. Dokumenti i transferimit te mbetjeve jo te rrezikshme plotesohet dhe nenshkruhet nga krijuesi i mbetjeve, grumbulluesi, transportuesi dhe pritesi qe merr ne dorezim mbetjet. **Per cdo transferim mbetjesh do mbahet nje dokumentacin ne te cilen do te shenohet data perkatese, per llojin e mbetjes, volumet, gjendjen e tyre dhe pozicionin e venddepozitimit.**

8. INFORMACION PER KOHEZGJATJEN E MUNDSHME TE NDIKIMEVE NEGATIVE TE IDENTIFIKUARA

1. Faza e ndertimit (per nje periudhe te caktuar sipas grafikut te punimeve)
2. Faza e operimit (sa jetegjatesia e objektit).

Kohezgjatja e ndikimeve kryesore perkon me kohezgjatjen e punimeve te ndertimit. Kohezgjatja e rehabilitimit dhe ndertimit te objektit do te jete po aq sa kohezgjatja e punimeve, nga data e marrjes se lejes se ndertimit Siperfaqja qe do te preket do te rehabilitohet paralel me kohen dhe fazen e rehabilitimit e ndertimit..

9. TE DHENA PER SHTRIRJEN E MUNDSHME HAPESINORE TE NDIKIMIT NEGATIV NE MJEDIS, QE NENKUPTON DISTANCEN FIZIKE NGA VENDNDODHJA E PROJEKTIT, DHE VLERAT E NDIKUARA QE PERFSHIHEN NE TE

9.1 Hapesira ku do te ndertohet vepra , ndikimet negative

Ndikimi negativ ne kete siperfaqe do te jete kryesisht ne germimin e dherave per hapjen e themeleve te objektit. Materialet qe do te dalin gjate zbatimit te objektit do te dergohen ne venddepozitimin e miratuar nga bashkia.

9.2 Hapesira jashte siperfaqes ku do te ndertohen veprat qe do kete ndikime negative

Jashte siperfaqes se ndertimit te vepres, ndikime negative do te kemi vetem ne zhurmat, ngritja e pluhurit dhe vibrimet te cilat i permendem dhe me siper per marrjen e masave te tyre. Ndikimi i tyre do te jete brenda normave te lejuar dhe oraret e punimeve do te zgjidhen ne menyre te tille qe te mos kete shqetesime per banoret e zones. Analiza e kryer ne kete raport ne lidhje me ndikimet e mundshme ne mjedis te projektit tregon se ato jane te kufizuara dhe pa pasoja te rendesishme. Po keshtu edhe kohezgjatja e ndikimeve qe mund te konsiderohen te rendesishme eshte e limituar.

9.3 Ndikimi i Projektit Gjate Fazes se Ndertimit

Ndikimet i klasifikojme sipas fazave te zhvillimit te projektit dhe natyres se tyre dhe mund t'i ndajme:

- ndryshim peizazhi: nga germimet e tokes, nga zbatimi i projektit
- zhurma, pluhuri dhe gazrat djegese te motoreve te mjeteve te punes.
- zhvendosje e nje sasie te madhe lende ndertimi cilet parashikohen te shfrytezohen.

9.4 Ndikimi i Projektit Gjate Fazes se Shfrytezimit

Gjate fazes se shfrytezimit nuk do te kete ndikime negative ne mjedis, pervec ndikimit pozitiv, per funksionimin e sherbimeve te policise se shtetit.

10. MUNDESITE E REHABILITIMIT TE MJEDISIT TE NDIKUAR DHE MUNDESINE E KTHIMIT TE MJEDISIT TE NDIKUAR TE SIPERFAQES NE GJENDJEN E MEPARSHME

- Projekti ka nevojë për monitorim mjedisor rigoroz nga organet kompetente mbikqyrese në kuadrin e mbajtjes nën kontroll të parametrave mjedisor si dhe të veprave të vecanta inxhinierike. Pas ndertimit të veprave duhet të mbahet nën mbikqyrje rehabilitimi i zonave të prekura nga punimet.

Monitorimi i ndikimit ne mjedis duhet te kryhet nga inspektore te specializuar per mbrojtjen e mjedisit, te kontrollit te ujrave, sherbimit pyjor, pushtetit vendor dhe qendror, MM – ja dhe ARM – ja. Plani i rehabilitimi ka si qellim qe nepermjet realizimit te tije te arrihet mbrojtja e tokes nepermjet veshjes pyjore te saj, si dhe permiresimit mjedisor te territorit. Gjate aktivitetit per realizimin e projektit do te kete krijim pargjesh te materialt te ngurte te germuar por jo te demshme.

Ne baze te ligjit nr.10 463, date 22.9.2011 “Per menaxhimin e integruar te mbetjeve” , I ndryshuar si dhe ligjit 32/2013, date 14.02.2013 “Per disa shtesa dhe ndryshime ne ligjin nr.10 463, date 22.9.2011 Per menaxhimin e integruar te mbetjeve” shprehim qe, gjate rikonstruksionit te objektit, mbetjet qe do te gjenerohen do te dergohen ne venddepozitimin e miratuar nga bashkia Tirane.

Mjetet teknologjike qe do transportojne mbetjet do te jene te pajisur me license te tipit III.2.B si detyrim i ligjit nr 10463,date: 22.09.2011 “Per menaxhimin e integruar te mbetjeve” i ndryshuar. Sasia e mbetjeve inerte si copa kartoni, leter, mbjetjet e ambalazhit te materiale te ndertimit do depozitohen ne vedndepozitimin e mbetjeve te miratuar nga Bashkia Tirane.

Si rregull te gjitha materialet e germuara te cilat nuk mund te perdoren do te ngarkohen per ne vendin e grumbullimit jashte zones se punes ne cdo distance te miratuar. Si rregull, pervecse kur specifikohet ndryshe, depozitimi ne vendet e grumbullimit do te kryhet ne perputhje me kushtet e meposhtme: -Per germimin qe ka lidhje me drenazhet, kanalet kryesore dhe rruget; minimumi ne nje distance prej 5 metra nga ana e jashtme e strukture: -Per strukturat e themeleve, etj, jashte zones se punimeve.



Pamje e objektit pas perfundimit te ndertimit dhe rehabilitimit

10.1 Plani i rehabilitimit te mjedisit

Plani i rehabilitimit ka si qellim qe nepermjet realizimit te tij te arrihet mbrojtja e tokes nepermjet veshjes me bimesi te saj si dhe permiresimi mjedisor sa me efikas i territorit te demtuar. Ky proces do te behen ne momentin qe do krijohen kushtet e pershtatshme per mbjelljen e bimesise. Kjo periudhe perkon me momentin e mbylljes se fazes ndertimore te objektit dhe risistemimin perfundimtare te dherave. Kjo menyre e te proceduari eshte per te zvogeluar rrezikun e erozionit te mundshem per shkak te shesheve te hapura.

I marre ne teresi plani i rehabilitimit ka ne kontekst ndermarrjen e veprimeve konkrete ne pyllzezimin e nje siperfaqeje te caktuar ne funksion te mbrojtjes se tokes dhe permiresimin mjedisor ne teresi

Mbellja e bimesise

- ✚ Punimet ne mbjelljen e bimesise do te konsistojne kryesisht:
- ✚ Skema e mbjelljes do te jete 3x2.2 metra
- ✚ Gropat do te hapen ne permasat 40x40x40 cm
- ✚ Gjate hapjes se gropes gjysma e pare e dheut te germuar hidhet ne anen e majte te gropes dhe gjysma e dyte e dheut te germuar ne anen e djathte te gropes
- ✚ Pas perfundimit te hapjes se gropave sipas projektit nga komisioni qe merr punen ne dorezim behet kolaudimi i punimeve te kryera e numerimi i gropave te hapura dhe ne rast se punimet jane konform rregullave vazhdohet me mbjelljen e fidaneve.
- ✚ Fidanet qe do te perdoren per mbjellje do te percaktohen nga specialistet e fushes dhe do te jene te certifikuar me certificate origjine dhe cilesie te leshuar nga subjekte te licensuar per kete qellim
- ✚ Fidanet e shkukur nuk duhet te lihen per asnje moment ne siperfaqe pa u shtratifikuuar per te mos u demtuar nga ngricat apo demtues te ndryshem.
- ✚ Puna per mbjelljen e fidaneve per nje grope behet nga 2 punetor, njeri mban fidanin ne menyre perpendikulare me themelin e gropes dhe punetori tjetër ben mbushjen me dhe te gropes.
- ✚ Mbjellja e fidaneve nuk duhet te behet ne periudhe me ngrica.
- ✚ Mbjellja e fidane eshte me mire te behen ne periudhen pasi te kete pushuar vegjetacioni.

Procedura e punes:

- ✚ Pergatitje piketash
- ✚ Piketim gropash
- ✚ Hapje gropash 40x40x40 cm
- ✚ Transport fidanesh
- ✚ Mbjellje fidanesh 40x40x40 cm
- ✚ Punetor mirembajtes dhe mbikqyrës se veprimeve
- ✚ Blerje fidanesh
- ✚ Transport fidanesh
- ✚ Prashitje fidanesh

Projekti i zbatimit sipas detyres se projektimit, nuk le shume hapësira per mbjelljen e siperfaqeve te reja me fidane. Zona e projektit i perket nje zone urbane dhe gjate projektimit te objektit eshte patur parasysh plani urbanistik i zones dhe plan i ish repartit Renea. Do te kete sistemim te zones se prekur nga punimet dhe mbjellje te siperfaqeve te gjelberta (bar dhe peme dekorative).



Pamje e objektit pas perfundimit te ndertimit dhe rehabilitimit



Pamje e objektit pas perfundimit te ndertimit dhe rehabilitimit

Procesi per sistemimin ku do te krijohen hapesira e terreneve te prekura nga investimi dhe riaftesimin e territorit me gjelberim, nepermjet mbjelljes se pemeve apo barit do te filloje gjate dhe mbas fillimit te shfrytezimit, duke bere mbjellje bari dhe fidanesh dekorative te here pas hershme. Ky proces do te behet mbas nje periudhe e cila rezulton me krijimin e kushteve te pershtatshme per mbjelljen e fidaneve. Te gjitha operacionet e me sipërme do te behen ne perputhje me teknikat e duhura dhe afatet kohore te pershtatshme per te siguruar suksesin e çdo operacioni sidomos mbjelljet qe realizohen vetem ne kushte te veçanta klimatike pedologjike. Po keshtu kujdesi i vazhdueshem do te konsiderohet si shtylla e planit te rehabilitimit deri ne fazen sa te realizohen sukseset e para biologjike dhe te arrihet klimaksi dinamik i bimesise dhe zhvillimi i proçeseve natyrore ne objekt.

 Domosdoshmeria e realizimit te ketij projekti inicohet nga:

- Shtimi gjithnje ne rritje i nevojës per siperfaqe me gjelberim
- Projekti krijon kushte te favorshme per shtimin e siperfaqes se mbuluar me bimesi
- Permiresimin mjedisor te territorit etj.

I marre ne teresi plani i rehabilitimit ka ne kontekst ndermarrjen e veprimeve konkrete ne sistemimin dhe mbjelljen e siperfaqeve te lira me bimesi, ne funksion te mbrojtjes tokes, permiresimit mjedisor, ne plotsimin e kerkesave te komunitetit si dhe te permiresimit te kushteve jetesore te tyre.

Te gjitha operacionet e me sipërme do te behën ne përputhje me teknikat e duhura dhe afatet kohore te përshtatshme për te siguruar suksesin e çdo operacioni sidomos mbjelljet qe realizohen vetëm ne kushte te veçanta klimatike pedologjike. Po keshtu kujdesi i vazhdueshem do te konsiderohet si shtylla e planit te rehabilitimit deri ne fazen sa te realizohen sukseset e para biologjike dhe te arrihet klimaksi dinamik i bimesise dhe zhvillimi i proçeseve natyrore ne objekt.

Domosdoshmeria e realizimit te ketij projekti inicohet nga:

- Shtimi gjithnje ne rritje i nevojës per siperfaqe te gjelberta
- Projekti krijon kushte te favorshme per shtimin e siperfaqes se gjelbert
- Permiresimin mjedisor te territorit etj.

11. MASAT REHABILITUESE NE RAST NDOTJE DHE DEMENTIMI NE MJEDIS

Masa mbrojtese dhe parandaluese qe rekomandohen gjate fazes se ndertimit. Kerketat mjedisore qe synojne mbrojtjen e shendetit e te mjedisit, perfshijne specifikimin e kushteve, normave e standarteve te detyrueshme per mbrojtjen e pastertise se ajrit urban, te ujerave sipërfaqesore e nentokesore, te cilesise e vlerave te tokes, te terrioreve urbane, rrugëve, trotuareve, zonave te gjelberuara.

- ✚ **Rrethimi** i zones se ndertimit do te behet me llamarine ne te gjithë perimetrin e saj per te shmangur daljen e gjithfare mbeturinash inerte, per te bere nje plan organizimi sa me te mire te objektit dhe per te shmangur gjithashtu impaktin negativ qe krijojne punimet.
- ✚ **Largimi i dherave qe do te dalin gjate hapjes se themeleve per krijim i vaskes si dhe gjate hapjes se kanalizimeve per shtrimin e rrjetit te tubacioneve**, do te kryhet brenda nje kohe shume te shkurter nga krijimi i tyre duke mos krijuar ndotje ne ambientin perreth. Largimi i tyre te behet naten duke marre masa per te mos ndotur rruget. Kjo realizohet duke mbuluar me mushama mbeturinat qe transportohen dhe duke i lare gomat e makinave para se te dalin nga sheshi i ndertimit. Mbetjet urbane do te grumbullohen ne perfundim te objektit ne vende te caktuara nga autoriteti perkates.
- ✚ **Rrjetat mbrojtese** per minimizimin e pluhurave dhe mbrojtjen e kalimtareve do te vendosen ne te gjithë terrioren e objektit qe do te kete punime.
- ✚ **Realizimi i infrastruktures** se brendshme rrugore do te realizohet ne perputhje me studimin urbanistik te zones perkatese duke i lene vend edhe sipërfaqes se gjelbert sipas projektit.
- ✚ **Kantieri i ndertimit** do te jete i rrethuar deri ne perfundimin e punimeve perreth objektit.
- ✚ **Mbeturinat ne perfundimin e fazes se ndertimit** do te grumbullohen, transportohen dhe depozitohen ne oraret e caktuara.
- ✚ **Nderhyrjet ne rrjetin e infrastruktures** do te kryhen me lejen e institucioneve perkatese sipas ligjeve ne fuqi. Ndertimi do te kryhet nen kontrollin e inspektoreve te mjedisit, per te matur ndotjet ne mjedis te cilat nuk duhet t'i kalojne parametrat e lejuar.

11.1 Masat konkrete per mbrojtjen e cilesise se ajrit

Me qellim qe shkarkimet ne ajer qe emeton veprimtaria ndertuese te jene vazhdimisht brenda normave te lejuara, subjektet ndertues, marrin keto masa:

- ✚ te perdoren mbulesa te perkohshme dhe te lagen sipas nevojës, nje deri dy here ne dite per te reduktuar çlirimet e pluhurave;
- ✚ per levizjen e materialeve ne kantier e ne sheshe ndertimi, te perdoren konteniere te mbyllur;
- ✚ te mirembahet sheshi i ndertimit gjate kryerjes se aktiviteteve te nivelimit, ndertimit dhe transportit;
- ✚ te gjitha ngarkesat te sigurohen nepermjet rregullimit, lagies ose mjete te tjera per te parandaluar derdhjet, rrjedhjet dhe pluhurat;
- ✚ te gjitha materialet e transportuara jashte sheshit te ndertimit te jene te lagura ne menyre te mjaftueshme ose te mbuluara mire;
- ✚ te gjitha aktivitetet e pastrimit, nivelimit, ndertimit dhe transportit te nderpriten gjate periudhave me ere te forte;
- ✚ te kufizohet shpejtesia e levizjes se kamioneve ne kalimet e sheshit te ndertimit, deri ne 30 km/ore;
- ✚ te ndalohet pergatitja dhe perpunimi i bitumeve ne temperatura te larta ne kantieret e ndertimit dhe te perdoren bitume qe kane shkalle te vogel çlirimesh te ndotesve ne ajer;
- ✚ te vendosen mbulesa mbrojtese per mbeturinat e ekspozuara ndaj eres;
- ✚ gjate kryerjes se proceseve te rifinitures (suvatim, lysterje, veshje fasade), objekti te jete i mbuluar me rrjeta mbrojtese
- ✚ Kompania investuese krahas zbatimit te projektit inxhinierik do te hartoje nje plan rehabilitimi te zones se projektit, vecanerisht aty ku toka i eshte nenshtruar punimeve te germimit.

Nga pajisjet operuese gjate aktiviteteve ndertimore. Aktivitetet operuese gjate ndertimit te objektit mund te shkaktojne shperndarjen e pluhurave ne atmosfere dhe uljen e cilesise se ajrit ne zone, te cilat shkaktohen si rezultat i çlirimit te gazeve te makinerive te ndertimit dhe mirembajtjes.

Emetimet ne ajer mund te shkaktohen nga gazrat e motoreve me djegie te brendshme te makinerive te ngarkimit (me rendesi emetimi i Pb-it nga motore me lende djegese benzine) dhe te transportuesve qe do te perdoren gjate ndertimit (prania e impiantit te cimentos, betonieret, etj).

Nga punimet ne sheshin e ndertimit. Do te kete prishje te objekteve ekzistese ne kete zone pasi ka objekte ne kete prone, dhe zbatuesi i punimeve duhet te beje kujdes gjate prishjes. ³/₄ Punimet e germimit mund te shkaktojne shperndarjen e pluhurave ne atmosfere dhe uljen e cilesise se ajrit ne zone. Gjate transportimit te mbetjeve ndertimore(inerteve) dhe gjate depozitimit te materialeve te nevojshme gjate ndertimit.

11.2 Masat konkrete per administrimin e mbetjeve te ngurta

Subjektet ndertues te godinave, rrugeve, urave, shesheve, te administrojne mbetjet qe gjenerohen nga veprimtaria ndertuese, duke marre keto masa:

-  mbetjet qe gjenerohen nga veprimtaria ndertimore, te sistemohen te ndara e te veçuara sipas llojit te tyre, ne vende te paracaktuara qe me pare per qendrimin e tyre provizor;
-  mbetjet te largohen çdo dite nga sheshi i ndertimit dhe te dergohen ne vendgrumbullimet e percaktuara nga pushteti vendor.
-  te pastrohen menjehere ne raste aksidentale rrjedhjet, derdhjet, pikimet per te parandaluar ndotjen e tokes;
-  te shtrohen me zhavorr dhe te mirembahen rruget brenda sheshit te ndertimit;
-  sherbimet dhe riparimet e makinerive e te pajisjeve te behen sipas grafikut dhe ne vende te percaktuara per kete qellim.
-  te lahen gomat e automjeteve para daljes nga sheshi i ndertimit.

11.3 Masat konkrete per mbrojtjen nga zhurmat

Ne çdo kantier ose shesh ndertimi, subjektet ndertuese, hartojne dhe zbatojne programin e masave per mbrojtjen nga zhurmat, i cili synon:

-  te respektohen standardet per nivelin e zhurmave;
-  aktivitetet e prishjes dhe te ndertimit, te kufizohen ne oret qe sjellin shqetesime per banoret perreth;
-  aktivitetet e prishjes dhe ndertimit te programohen sipas nje grafiku ne menyre qe te evitohet operimi i disa pajisjeve e makinerive ne te njejten kohe i cili shkakton nivele te larta zhurmash;
-  makinerite e pajisjet e fuqishme te ndertimit, si dhe ato qe gjenerojne zhurma mbi kufijte e lejuar, te jene te pajisura me ekrane mbrojtjes per zhurmat.

Zhurmat jane nje ndikim i pashmangshem mbi mjedisin gjate ndertimit. Zhurma mund te kufizohet duke ndjekur praktikat e mire-administrimit (pajisje/makineri te kalibruara) qe nenkuptojne se punimet do te kryhen vetem gjate orarit te rregullt te turneve te punes. Pajisjet e ndertimit do te plotesojne te gjitha standartet e zbatueshme te Direktives se BE 2000/14/EC, e Majit 2000. Kjo Direktive zbatohet per prodhuesit e pajisjeve qe shkaktojne zhurme. Te gjitha pajisjet duhet te mirembahen ne gjendje te mire pune. Oraret e transportimit te materialeve te ndertimit ne rruget e daljes do te caktohen me kujdes ne menyre qe te menjanohet çdo shqetesim i trafikut lokal.

Funksionimi i sheshit do te ndalohej nga ora 19.00 – 7.00, çdo dite. Ndotja nga zhurmat mund te vije nga perdorimi i makinerive ne ambientin e punes. Ne projektin tone te marre ne studim, zhurmat do te shkaktohen kryesisht nga puna gjate fazes se ndertimit e mjeteve te renda te germimit, te transportit, te ngarkim-shkarkimit. Megjithate, niveli i zhurmave te krijuara do te jete ne perputhje me udhezimin e permenduar me siper, dhe nuk do ta kaloje kete kufi. Zhurma do te jete e perkohshme dhe nuk do te kete akumulim te saj nga receptori njeri.

Paksa te ekspozura nga ketyre zhurmave do te jene punonjesit qe do te punojne ne kantier, per te cilet do te kerkohet zbatimi i masave te sigurimit teknik ne pune dhe misdis te tjerash dhe perdorimi i kufjeve. Zona e banuar ndodhet afer me pjesen ku do te ndertohet objekti qe do te shkaktojne zhurmat dhe vibrimet jane te paraqitura ne menyre te permblendhur si me poshte:

Si pasoje e punes se mjeteve te ngarkimit dhe te transportit te materiale apo inerteve: Ndikime nga zhurmat do te shkaktohen nga mjetet e ndertimit siç mund te jene; vinçi, bulldozeri, betonier, betonierat e vegjel, eskavatore, kamionat qe transportojne materialet e ndertimit, etj.

- Te shkaktuar gjate ndertimit te karabinase dhe gjate perfundimit te objektit.
- Gjate ndertimit te karabinase do te ndikoj ne rritje te nivelit te ndotjes akustike, por ndikimi i tyre do te jete i perkohshem vetem gjate ndertimit.
- Do te shkaktohet zhurme dhe gjate montimit te pajisjeve te nevojshme per kete objekt. Te shkaktuar nga prania e punonjesve ne kantier:

Prania e punonjesve do te kete ndikim ne rritje te nivelit te zhurmave nga bisedat e tyre sidomos gjate oreve te nates.

Te shkaktuara gjate kalimit te mjeteve te ndertimit te tonazhit te larte: Do te ndihen vibrime ne mjedisin aty prane. Do te shkatohen vibrime dhe nga vibriatori i llacit qe do te perdoret per te realizuar shperndarjen e llacit mire neper kallepin e kollonave, etj. Gjate ndertimit do te ndikohet vetem ne jeten e punonjesve te ndertimit dhe si dhe ne mjedis e banuar aty prane sheshit te ndertimit, por ndikimi do te jete ne nivele te ulta.

Zhurma e krijuar nuk do te jete e ndryshme nga zhurma e pergjithshme e krijuar nga punimet e ndertimeve civile. Zhurma pritet te jete e moderuar por e perkohshme pasi kontraktuesit

aplikojne teknologjine me te fundit per kontrollin e uljeve te vibrimeve dhe zhurmave ne menyre te konsiderueshme pa rritje te shpenzimeve operative. Matjet shkencore kane treguar nje ulje prej te pakten 35-40% te nivelit te impaktit te vibrimeve.

❖ Masat konkrete per mbrojtjen nga zjarri

Per secilen godine jane parashikuar masat ndaj zjarrit (raporti perkates). Godinat e projektuar per nga kategoria e aktivitetit nuk paraqesin specifika te vecanta per rrezikshmeri te theksuar zjarri, por duke qene se siperfaqet e tyre jane te vleresuara me nje rrezik dhe potencial zjarri, per shkak te dimensioneve dhe ndodhja njekohesisht e numrit te madh te personave, atehere detyrimisht bazuar edhe ne Udhezimin Nr.425, date 24.7.2015 si me siper kerkohet hartimi projekteve specifike

Nje aspekt i rendesishem i evakuimit ne ndertesa shume kateshe eshte pasqisja me nje numer te pershtatshem shkallesh emergjence. Ky paragraf merret me shkallet e emergjences dhe perfshin masat e nevojshme per mbrojtjen e ketyre shkalleve ne te gjitha llojet e ndertesave. Kufizimi i distancave horizontale per qellimin e evakuimit do te thote qe shumica e personave duhet te jene te afte te gjejne nje rruge te mbrojtur ose nje dalje ne menyre te pavarur nga te tjeret. Sidoqofte, disa persona, pershembull personat me aftesi te kufizuara apo femijet, mund te mos jene te ne gjendje te perdorin shkallet pa shoqerues. Per keta persona evakuimi ne nje zone te sigurt (refuge) ose ne nje rruge evakuimi dhe perdorimi i shkalleve duhet te behet me shoqerues.

Numri i shkalleve te emergjences

Numri i shkalleve te emergjences te nevojshme ne nje ndertese (ose pjese te nje ndertese) do te percaktohet nga:

- kufizimet e dhena me poshte per projektimin e rrugëve te evakuimit horizontale
- nqs pranohen disnivelet si ne seksione me poshte
- prania e nje gjerësie te pershtatshme per evakuim, duke marre parasysh qe nje shkalle mund te hiqet per shkak te zjarrit ose tymit.

- Shkallet me nje rruge evakuimi

Idealisht, shkallet me nje rruge evakuimi duhet te shmangen nga perdorimi ne ndertesa te reja. Situatat ku mund te perdoren keto lloj shkallesh ne nje ndertese (ose ne nje pjese te ndertesës) jane: ne nje bodrum ku lejohet te kemi shkalle me nje rruge evakuimi sic u pa ne seksionin me siper dhe ne nje ndertese qe nuk ka me shume se 3 kate dhe ku cdo kat lejohet te kete keto lloj hkallesh.

- Parashikimi i zonave te shpetimit

Me poshte jane disa shembuj te zonave te shpetimit te pranueshme: nje siperfaqe qe mund te jete e ndare me korridor te mbrojtur ose me shkalle te mbrojtura, nje siperfaqe e hapur si nje ballkon ose nje vend i ngjashem qe eshte i mbrojtur mjaftueshem nga rreziku i zjarrit dhe qe eshte i pajisur me rruget e evakuimit.

- Mbrojtja e rrugeve te evakuimit

Nese nje zjarr bie, dhe fillon te perhapet neper godine, nuk duhet qe te rrezikohen rruget e evakuimit te cilat jane te dedikuara dhe te mbrojtura. Rruge te tilla jane te mbrojtura nga elemente ndertimore te cilat jane te kenaqshme persa i perket testeve te rezistences ndaj zjarrit.

- Rezistenca e zjarrit ne zonat e mbyllura.

Te tjere elemente strukture mund te kerkohen ne menyre qe te sigurohet qendrueshmeria ndaj zjarrit per qellimet e meposhtme: per te zvogeluar zonen e nderteses qe eshte ne rrezik, ne perputhje me rekomandimet, Mbrojtjen kunder demeve disproporcionale te objektit ne rast te renjes se zjarrit, Izolimin e zonave me rrezik te larte, Mbrojtjen e zonave qe jane kritike per daljen nga shkollat ,ose qe jane shume te rendesishme. Pergjithesisht koha standarte mesatar per mbrojtjen nga zjarri te elementeve te evakuimit eshte 30 minuta.

- Dyert ne rruget e evakuimit.

Koha qe duhet per te hapur nje dere te mbyllur eshte shume e rendesishme gjate evakuimit. Dyert ne rruget e evakuimit brenda dhe jashte godines duhet rrjedhimisht te jene menjehere te hapshme ne menyre qe te mos kete vonesa.

- Mbyllesit e dyerve.

Ne pergjithesi, dyert ne rruget e evakuimit (dyer kunder zjarrit ose jo), nuk duhet te jene te kycura me celes, me shul apo me vida. Ato duhet te jene te fiksuara me mbylles te cilet duhet te jene lehtesisht te hapshem nga njerezit te cilet jane duke u evakuuar. Keto mbyllesa duhet te jene te dallueshem, pa nevojën e perdorimit te celesave dhe te mos duhet te perdoret me shume sesa nje mekanizem hapes. Kur nje dere duhet te hapet me ane te ndonje kodi, kombinimi apo karte ,ajo duhet gjithashtu te siguroje lejimin e kalimit te njerezve te cilet po evakohen.

Kycet te cilet punojne me energji elektrike duhet te jene ne pozicionin e hapur ne rastet kur:

- Bie sistemi i alarmit te zjarrit.
- Nderpritet energjia elektrike
- Ndodhin gabime te sistemit.
- Aktivizohet njesia e hapjes se deres ne ate ane ku afrohen njerez te cilet duan te evakohen. Kur dera perdoret per evakuim edhe ne drejtimin tjeter ajo duhet te pajiset me njesi te hapjes se deres ne te dyja anet e saj.

Dyert ne rruget e evakuimit te dhomave me kapacitet me te madh se 60 persona nuk duhet te pajisen me celesa, shula apo me bullona. Mund te jete e pranueshme qe ne disa dyer te jashtme te daljes , per siguri, te perdoren mbyllesa por vetem ne rastet kur godina eshte bosh.

- Drejtimet e hapjes.

Dera e cdo rrugedaje ose evakuimi, ne rastet kur eshte e mundur, duhet qe te hapet ne drejtimin e daljes se evakuimit. Ne rastet kur numri i personave qe do te dalin nga ajo dere eshte me i madh se 60, atehere drejtimi i hapjes duhet qe te jete i detyrueshem ne drejtim te evakuimit.

Shenim: Ne vende ku ka nje rrezik te larte te renjes se zjarrit dhe qe mund te kete shpejtesi te larte perhapje, dyert duhet te jene te hapshme ne drejtimin e evakuimit edhe ne ato raste kur numri i personave eshte me i vogel se 60.

- Hapja e deres dhe ndikimi ne rruget e evakuimit.

Te gjitha dyert ne rruget e evakuimit duhet qe te hapen jo me pak se 90 grade me nje krah hapje qe nuk pengohet nga ndonje ndryshim i nivelit te dyshemese, nga pragu apo ndonje gje tjeter. Nuk duhet qe te ndikojne ne gjeresine efektive te rruges se evakuimit. Nje dere qe hapet ne drejtim te korridorit apo te shkalleve nuk duhet qe te ndikojne ne gjeresine e shkalleve apo te korridorit.

- Dyert me dritare shikimi

Dyert me dritare nevojiten aty ku dyert ne rruget e evakuimit nderpresin korridoret ose ne rastet kur dyert jane te hapshme ne te dyja anet. Keto panele kur vendosen ne dyer izoluese duhet te jene zjarrruduese. Dritaret e ketyre dyerve duhet te kene nje siperfaqe me te vogel se 10% e siperfaqes se deres dhe te vendosen jo me poshte se 50 cm nga dyshemeja.

- Shkallet. Konstruksioni i shkalleve te evakuimit.

Shkallet dhe sheshpushimet e seciles shkalle evakuimi duhet te ndertohen nga materiale me djegshmeri te limituar ne situata si me poshte: Nese eshte e vetmja shkalle e godines ose pjese e godines, Nese eshte brenda nje kati nen toke, Nese eshte shkalle e jashtme, bNese eshte nje shkalle per zjarrefikesit.

- Dyshemete e rrugeve te evakuimit.

Dyshemete e te gjitha rrugeve te evakuimit (duke perfshire edhe bazamakete e shkalleve, rampat dhe sheshpushimet) duhet te zgjidhen te tilla qe te mbrojne nga rreshqitja.

- Daljet finale

Keto dalje duhet te dimensionohen ne menyre qe te thjeshtojne evakuimin e njerezve jashte godines. Ato nuk duhet te jene me te vogla sesa minimumi i gjereses se kerkuar per rruget e evakuimit per te cilat sherbejne. Keto dalje duhet te vendoset ne ate pozicion qe te siguroje shperndarjen e shpejte te personave ne afersi te godines ne menyre qe te mos jene ne rrezik nga zjarri dhe tymi. Duhet te sigurohet akses ne nje rruge, trotuar apo ne cfaredolloj hapsire tjeter per tu larguar pas daljes nga godina. Rruga jashte godines duhet te jete e percaktuar qarte dhe nese eshte e mundur te kete edhe mbrojtese te pershtatshme. Keto dalje nuk duhet te paraqesin pengese per personat me aftesi te kufizuar. Duhet qe te jene te dukshme per personat qe do ta perdorin. Duhet qe te jene te vendosura ne menyre qe te jene te mbrojtura nga zjarri ose tymi. Ndricimi i rrugeve te evakuimit.

- Shenjat e daljes

Te gjitha rruget e evakuimit (ndryshe nga ato qe perdoren zakonisht) duhet te pajisen me tabela te daljes se emergjences me permasa te caktuara.

Rrufepritesit

Per te evituar rrezikun e zjarrit, qe mund te vije nga shkarkimet atmosferike si ne godine apo dhe ne nenstacionin elektrik qe ndertohet prane godines, do te pajisen me sistemin mbrojtjes per shkarkimet atmosferike sipas kushteve teknike te projektimit te linjave elektrike dhe godinave industriale. Sistemi i mbrojtjes atmosferike eshte shume i domosdoshem, per vete kushtet atmosferike dhe vendodhjen gjeografike ne te cilat ndodhet vendi yne. Sistemi i mbrojtjes atmosferike eshte dhe duhet te ngrihet i pavarur, nga ai i sistemit te tokezimit dhe te plotesoje kushtet e zbatimit sipas KTZ –se se Shqiperise. Vlera e rezistences te ketij sistemi duhet te jete me e vogel se 1Ω . Gjate punes per kete sistem (pasi te jene vendosur elektrodave) kryhen matje te R dhe ne rast se ajo eshte me e madhe se 1Ω , atehere duhet rritur numri I elektrodave derisa te arrihet kjo vlere. Matjet duhen perseritur dy here. Nje here ne toke me lageshtire dhe nje here me toke te thate.

Materialet qe do te perdoren per kete sistem (shiritat, elektrodave qe do te futen ne toke, shigjeta, bulonat fiksues etj.) duhet te jene te gjitha prej zingu ose hekur te galvanizuar. Shiritat duhet te jene me permasa 40 mm x 4 mm ose 30 mm x 3 mm, ose shufer me diameter min. 10 mm. Elektrodave duhet te jene me gjatesi 1.5 m, si ne rastet kur do te perdoret hekur ne forme “L” (50 x 50 x 4 mm) i galvanizuar, ashtu edhe kur do te perdoren elektroda zingu te prodhuara nga fabrika. Shigjeta duhet te jete edhe ajo prej zingatoje, psh. nje tub zingatoje $\frac{3}{4}$ “, i cili behet me maje dhe ka gjatesi te tille qe te dal min. 0.6 m mbi pikat me te larta te objektit. Bulonat dhe dadot qe do te perdoren per fiksim te shiritit me elektrodave duhet te jene min. M 12.

12. PLANI I MONITORIMIT TE MJEDISIT

Monitorimi i cilesise se mjedisit mbetet ende nje nder ceshtjet paresore per institucionet shteterore ne vendin tone. Pavaresisht nga puna per plotesimin e kuadrit ligjor ne kete drejtim, mungesa e nje sistemi te plote monitorues per komponentet e ndryshme mjedisore dhe te shtrire ne te gjitha vendin, bashkeshoqerohet me nje pamje te manget mbi gjendjen e mjedisit dhe prirjet e tij ne kohe. Nje sistem monitorimi i pershtatshem dhe ne perputhje me standardet me te perparuara europiane do te ndihmoje per grumbullimin e te dhenave te nevojshme per vleresimin e prirjeve te zhvillimit, jo vetem te mjedisit, por edhe te atij kombetar ne teresi. Per me teper, ai do te jete nje mundesi e mire per dhenien e informacionit te sakte dhe te shpeshte publikut te interesuar, duke ndihmuar perfshirjen e me shume subjekteve dhe individeve ne vendimmarrjen mjedisore.

Nga ana tjeter, pervoja e grumbulluar pergjate disa dhjetevjeçareve, ne nivelin e institucioneve me tradite ne vleresimin e gjendjes mjedisore eshte nje baze e mire per ngritjen dhe pershtatjen e nje sistemi te ri monitorues. Analizimi i propozimeve te bera nga propozuaesi ne lidhje me objektivat ka ndihmuar per identifikimin e rreziqeve kryesore gjate zbatimit si dhe nevojten per te marre masa per zbutjen e pasojave negative. Objektivat per mbrojtjen e mjedisit dhe zhvillim te qendrueshem jane thelbesore ne rekomandimet e bera per zhvilluesin e aktivitetit.

Objektivat kryesore te monitorimit jane:

- ✚ Per te zbuluar ndryshimet dhe per te karakterizuar saktesisht nga ana sasiore tendencat (prirjet) e zhvillimit te burimeve.
- ✚ Per te siguruar informacione mbi lidhjen midis kushteve (gjendjeve) te burimeve dhe shkaqeve te tyre.
- ✚ Per te evidentuar cilesine e mjediseve ku njeriu ushtron aktivitetin e tij jetesor, me synim per te marre masat e nevojshme per permiresimin e tyre.
- ✚ Per te vleresuar efektivitetin e politikave dhe veprimeve per menaxhimin e burimeve natyrore.

Ne zhvillimin ekonomiko-shoqeror te nje vendi, gjithnje ne perputhje me parimin, tashme, universal te zhvillimit te qendrueshem, marrin rendesi te vecante evidentimi dhe gjetja e rrugeve dhe e teknologjive me efikase, si per shfrytezimin sa me racional te pasurive natyrore, ashtu dhe per kontrollin cilesor dhe sasior te ndikimit mbi mjedis dhe sidomos ne burimet ujore. *Keshilli i Ministrave, me vendimin Nr.1189, date 18.11.2009 "Per rregullat dhe procedurat per hartimin e zbatimin e programit kombetar te monitorimit te mjedisit", nder te tjera, ka percaktuar treguesit mjedisore: te gjendjes se mjedisit, te ndikimit ne mjedis dhe te trysnise ne mjedis. Mbi kete baze jane hartuar edhe Indikatoret Kombetar per Monitorimin e Mjedisit dhe eshte duke u punuar per hartimin e Planit Kombetar te Monitorimit te Mjedisit.*

Ndikimet negative qe pershkruam me siper mund te minimizohen duke marre dhe respektuar nje sere masash. Siç kemi theksuar ne shume kapituj te ketij materiali, ndotja qe i shkaktohet mjedisit eshte minimale ne krahasim me perfitimet qe do te sjelli projekti.

- *Monitorimin e parametrave gjeometrik te shkalleve te shfrytezimit te objektit si pjerresia, lartesia, kendi i skarpates, pjerresia e trasese si dhe te parametrave gjeometrik te parashikuar ne projekt.*
- *Monitorimi i parametrave fizik dhe dinamik te shperndarjes se pluhurit dhe marrja e masave perkatese te parashikuara ne projekt per parandalimin e tij.*
- *Monitorimi i siperfaqeve te mbushura me material dhe toke vegjetale per parandalimin e shperlarjeve, gerryerjeve, krjimin e gropave etj. Atje ku vihen re demtime te kesaj zone do te merren masa per riparimin e tyre.*
- *Monitorimin e siperfaqeve te mbjella te pemeve dhe bimeve te kultivuara, si dhe ecurise normale te mbirjes dhe zhvillimit te tyre.*

12.1 Plani i menaxhimit per zbatimin e projektit

PMM ka si qellim: parandalimin, minimizimin dhe menjanimin e ndikimeve negative ndaj mjedisit.

Plani i menaxhimit te mjedisit

- Plani i menaxhimit te mjedisit (duke perfshire edhe planin e veprimit mjedisor)
- Struktura e menaxhimit te mjedisit
- Kontrolli i zhurmes dhe i dridhjeve
- Plani i menaxhimit te cilesise se ajrit
- Mbrojtja e habitateve, botes bimore dhe shtazore
- Plani i menaxhimit te siperfaqes se tokes
- Plani i kontrollit te erozionit
- Plani i menaxhimit te ujerave
- Parandalimi i ndotjeve
- Plani i kontrollit te derdhjeve
- Plani i urgjences
- Plani i menaxhimit te mbetjeve
- Plani i menaxhimit te acideve
- Monitorimi dhe raportimi mjedisor
- Aksioni korigjues dhe i auditimit te mjedisit

❖ PLANI I MENAXHIMIT TË MBETURINAVE TË PRODHUARA GJATË ZBATIMIT TË PROJEKTIT

Praktika e menaxhimit të mbetjeve në tërësi

Nr.	Mbetjet	Riciklim/ Ripërdorim	Djegje	Varrosje	Depozitim
1	Mbeturina ndërtimi				
2	Mbeturina kampingu				
3	Mbeturina drusore				
4	Enë boshe				
5	Copëra betoni				
6	Rondele metalike				
7	Tokë e ndotur me kimikate				
8	Copëra leckash				
9	Mbeturina letre				
10	Mbeturina plastike				
11	Copëra tubash				

Mbetje të tjera të ngurta

Vlejnë të përmendim mbetjet e ndryshme ushqimore, që konsumohen e përdoren si rezultat i veprimtarisë jetësore të njerëzve. Ndër më kryesoret mund të veçojmë:

- Copa kartoni
- Pjesë plastike të paketimit
- Etiketa letre të dëmtuara
- Mbetje ushqimore të kuzhinës

13 . NDIKIMET ME NATYRE NDERKUFITARE

Projekti nuk shkakton ndikim negativ me natyre nderkufitare sepse zona e projektit i perket bashkise Tirane, nuk eshte zone nderkufitare.

14. PERFUNDIME DHE REKOMANDIME

Projekti ne fjale perputhet me planifikimin urban te zones.

Vetite fiziko-mekanike te shtresave qe takohen ne bazamentet shkembore dhe gjysemshkembore te objektit i plotesojne kerkesat projektimit per sigurine dhe qendrueshmerine e tyre.

Zbatimi i projektit do te ndikojte pozitivisht per Drejtorine e Forcës Së Posaçame Operacionale, ish reparti Renea.

Nga zhvillimi i aktivitetit do te krijohen mbetje te vogla, inerte apo betoni nga ndertimi i objekteve, etj. Detyrat kryesore qe do te kete parasysh stafi teknik jane:

- *Kontrolli i vazhdueshem i gjendjes se mjedisit ne territorin ku do te zhvillohet aktiviteti.*
- *Kontrolli teknik i paisjeve.*
- *Zbatimi masave te parashikuar ne raport.*
- *Mbajtja paster e gjithe territorit ku kryhet veprimtaria.*

Gjate rikonstruksionit te objektit dhe shfrytezimit te tij, Subjekti Ndertues, krahas problemeve te ngritura ne kete raport V.N.M ne vecanti duhet t'i kushtojte rendesi edhe faktoreve te meposhtem:

• *Te respektojte procedurat, normat, standartet dhe planifikimet e paraqitura ne projekt gjate realizimit te tij.*

• *Gjate zbatimit te projektit, subjekti ndertues duhet te respektojte dhe te vere ne zbatim programin e monitorimit, per te pasur vazhdimisht tregues mjedisore konform standarteve dhe normave si ne aspektin cilesor ashtu dhe ne ate sasior.*